

**VËLLIMI XXXI /TETOR-DHJETOR/ 2025**

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2025**

**BULETINI ZYRTAR**



## PËRMBAJTJA

Nr.1218, Datë 10.10.2025.....	5
“PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR.1211, DATË 11.09.2025, “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. DHE ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”	
Nr.1219, Datë 10.10.2025.....	8
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA TIMAK DEFENCE SHA NGA SHOQËRITË KAYO SHA DHE TIMAK SHPK”	
Nr.1220, Datë 10.10.2025.....	14
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA M.K.D SHA NGA SHOQËRITË KAYO SHA DHE MSSC SHPK.”	
Nr.1221, Datë 10.10.2025.....	19
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA GUNA TACTICAL SHA NGA SHOQËRITË KAYO SHA DHE MSSC SHPK.”	
Nr.1222, Datë 29.10.2025.....	24
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAST FOOD ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA KAN ALBANIA SHPK”	
Nr.1223, Datë 29.10.2025.....	26
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË HEAVEN BEACH SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”	
Nr.1224, Datë 29.10.2025.....	29
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË IE – ENERGY PROJEKT D.D. NGA SHOQËRITË BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, RAIFFEISEN DRUŠTVO ZA UPRAVLJANJE OBVEZNIK I DOBROVOLJNIM MIROVINSKIM	

FONDOVIMA D.D. DHE IND – EKO PLUS D.O.O.”

Nr.1225, Datë 29.10.2025.....	<b>35</b>
“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË THELLUAR PËR TRANSAKSIONIN E PROPOZUAR TË PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TRING TV SHA NGA SHOQËRIA VERTEX HOLDING SHPK”	
Nr.1227, Datë 18.11.2025.....	<b>41</b>
“NDËRMJET PALËVE TË TREGUT TË SIGURIMEVE MBI SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT PËR TREGUN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA””	
Nr.1228, Datë 18.11.2025.....	<b>46</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPACE+ SHA NGA SHOQËRIA GLG INVESTMENT SHPK”	
Nr.1229, Datë 18.11.2025.....	<b>51</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË QUMESHTI AJKA SHA NGA SHOQËRIA SAIMBEI SHPK”	
Nr.1230, Datë 18.11.2025.....	<b>55</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË MERCATOR-EMBA, PROIZVODNJA HRANE, D.O.O. NGA SHOQËRIA AGRANA INTERNATIONALE VERWALTUNGS-UND ASSET-MANAGEMENT GMBH”	
Nr.1231, Datë 18.11.2025.....	<b>59</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË NIDDA GERMAN TOPCO GMBH NGA SHOQËRIA SAXOPHONE GERMANY BIDCO GMBH”	
Nr.1232, Datë 26.11.2025.....	<b>63</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DIAL-ALB SHPK NGA SHOQËRIA EVITA SHPK”	
Nr.1233, Datë 26.11.2025.....	<b>67</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË KAUFMANN I HOFMANN D.O.O. NGA SHOQËRITË RMF RE D.O.O., WKB 4 GMBH DHE INTERCAPITAL HICP D.O.O.”	
Nr.1241, Datë 12.12.2025.....	<b>72</b>

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË NETFONE TELECOM TÁVKÖZLÉSI ÉS SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG TÁVKÖZLÉSI HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”	
Nr.1242, Datë 12.12.2025.....	<b>75</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË RÁBA JÁRMŰIPARI HOLDING NYRT. NGA SHOQËRIA 4IG SDT EGY ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”	
Nr.1243, Datë 12.12.2025.....	<b>79</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AI SIRONA (LUXEMBOURG) ACQUISITION S.À R.L. NGA SHOQËRIA ALTHEA ACQUISITION BIDCO S.À R.L.”	
Nr.1244, Datë 12.12.2025.....	<b>83</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TRING TV SHA NGA SHOQËRIA VERTEX HOLDING SHPK”	
Nr.1246, Datë 12.12.2025.....	<b>97</b>
“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJES SHPRESA - AL SHPK NË TREGUN E TRANSPORTIT URBAN NË BASHKINË KAMËZ”	
Nr.1247, Datë 19.12.2025.....	<b>100</b>
“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË FV PLANT 2 DRUŠTVO SA OGRANIČENOM ODGOVORNOŠĆU BEOGRAD - VRAČAR NGA SHOQËRIA GEN – I SONCE, ENERGETSKE STORITVE, D.O.O.”	
Nr.1248, Datë 19.12.2025.....	<b>104</b>
MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË SPECIALIZIMIT”	
Nr.1249, Datë 19.12.2025.....	<b>112</b>
MBI MIRATIMIN E RREGULLORES“PËR PËRJASHTIMIN NË BLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE VERTIKALE DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”	
Nr.1250, Datë 19.12.2025.....	<b>113</b>
MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI KUFIZIMET VERTIKALE”	

**VENDIM**

**Nr.1218, Datë 10.10.2025**

**“PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR.1211, DATË 11.09.2025, “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. DHE ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Ledia Matja	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, germa d i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pasi shqyrtoi relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”,

**VËREN SE :**

Komisionit të Konkurrencës me Vendimin nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU

GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”, autorizoi transaksionin e njoftuar.

Me shkresën nr. 701/8 prot., i AK datë 01.10.2025 “Kërkesë për korrigjim Vendimi”, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar, nga pala njoftuese, në lidhje me një gabim material të shprehur në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025.

Pala njoftuese ka deklaruar se në Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit të hartuar prej tyre, ka pasur një pasaktësi në lidhje me cilësimin e njëres prej palëve pjesëmarrëse në përqendrim, konkretisht: *“Eurizon Capital nga ana tjetër është në pronësi të plotë (dhe për këtë arsye e kontrolluar ekskluzivisht) nga ISP, një shoqëri italiane me kod tatimor 00799960158 dhe seli të regjistruar në Torino, Piazza San Carlo 156 – 10121, dhe kompani holding e Intesa Sanpaolo Group”*, paragraf i cili është pasqyruar në pjesën arsyetuese të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Pala njoftuese sqaron se ky paragraf është relatuar i pasaktë në Formular, përse i përket cilësimit të njëres prej palëve pjesëmarrëse në përqendrim, dhe ka kërkuar korrigjimin e këtij paragrafi duke cilësuar se: *Eurizon është një nga shoqëritë pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo dhe jo shoqëri holding e Grupit Intesa Sanpaolo, që në fakt është ISP.*

Në nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Komisioni i Konkurrencës gjykon se ky gabim material nuk cenon thelbin e aktit administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 112 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

- I.** Në faqen nr. 2 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11 .09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”, paragrafi i

katërt i pikës I. “Palët në transaksion dhe procedura”: “*EURIZON CAPITAL SGR S.P.A. është shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Italian, e regjistruar në Torino dhe shoqëria holding e Intesa Sanpaolo Group*”, të korrigohet dhe të zëvendësohet me paragrafin “*EURIZON CAPITAL SGR S.P.A. është shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Italian, e regjistruar në Torino dhe pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo.*”.

**II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr. 1219, Datë 10.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA TIMAK DEFENCE SHA NGA SHOQËRITË KAYO SHA DHE TIMAK SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK”.

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

**Pala 1: KAYO SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Shoqëria ka objekt veprimtarie projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake,

uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake. Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria ndjek gjithashtu interesa ekonomikë dhe tregtarë. Objektivat kryesore të aktivitetit të Shoqërisë janë, si më poshtë: a) projektimi, prodhimi, riparimi, demilitarizimi, asgjësimi dhe tregtimi, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake; b) ngritja, zhvillimi dhe forcimi i industrisë së prodhimit e të tregtimit të armëve, me qëllim sigurimin e nevojave të Forcave të Armatosura dhe ato të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të realizimit të fitimit ekonomik; c) prodhimi dhe furnizimi me pajisje të nevojshme për Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e interesave kombëtare; ç) ndërtimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve vendase për të prodhuar e furnizuar Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë me pajisje të nevojshme për operacionet e tyre; d) mobilizimi i kapitalit shtetëror dhe/ose privat në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj; dh) nxitja e investimeve në teknologji dhe inovacion për prodhimin, përdorimin, tregtimin e armëve brenda dhe jashtë vendit; e) bashkëpunimi me subjekte të ndryshme shtetërore e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e objektit të veprimtarisë së saj; ë) financimi ose bashkëfinancimi i projekteve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike të ngritura për realizimin e tyre. (2) Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet me aktivitetin e saj. Kjo përfshin gjithashtu edhe të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Aksionar i kësaj shoqërie është Ministria e Mbrojtjes me 100% të aksioneve.

Në tregun e brendshëm, shoqëria KAYO SHA zotëron paketën kontrolluese të shoqëritë GUNA TACTICAL SHA dhe M.K.D SHA.

**Pala 2: TIMAK SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, ku objekt kryesor i aktivitetit të shoqërisë është prodhimi, konvertimi dhe montimi i konstruksioneve metalike dhe plastike për të gjitha llojet e makinerive dhe automjeteve të ndryshme të automjeteve ushtarake, mjeteve për përdorim të veçantë si ambulancat, kamionët e zjarrfikësve, automjetet e pastrimit, automjetet për përdorim industrial dhe të tjera, pa përjashtim. Blerja dhe shitja e makinerive, pjesëve të këmbimit, pajisjeve, mjeteve shtesë dhe ndihmëse për të gjitha llojet e automjeteve. Ofrimi i ekspertizës dhe/ose shërbimeve profesionale në fushën e transportit rrugor. Ofrimi i shërbimeve të riparimit për automjete motorike dhe rimorkio. Dhënia e shërbimeve konsulente për biznese, si dhe zbatimi i projekteve të zhvillimit për subjekte private, institucione qeveritare dhe institucione financiare, si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Përveç

sa më sipër, shoqëria do të kryejë edhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe çdo aktivitet ndihmës që lidhet me aktivitetet e mësipërme. Në vijim të sa më sipër, shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në zhvillimin, furnizimin dhe ofrimin e mbështetjes për: • Automjetet ushtarake të blinduara, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në, automjete të mbrojtura nga pritrat dhe rezistente ndaj minave (MRAP), transportuesve të blinduar të personelit (ATP) dhe automjeteve taktike për reagim të shpejtë, si SHOTA ose platforma të ngjashme; etj.

TIMAK SHPK zotërohet XX nga Arjeta Puca dhe XX nga Ron Yeffet.

**Ndërmarrja e përbashkët (JV): TIMAK DEFENCE SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, ku objekt i veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi ose përshtatja e mjeteve motorike të posaçme me një arkitekturë të hapur që lejon instalimin e sistemeve të armatimit, siç janë armët automatike, sistemet e artilerisë, pajisjet antidron, mbrojtje aktive e mjetit, pajisje për përdorim urban dhe çdo sistem tjetër që kërkohet nga forcat e armatosura apo struktura të tjera të sigurisë, për t'u përdorur nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, strukturat e sigurisë dhe të emergjencave civile dhe klientë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë. Në këtë kuadër, Shoqëria mund të prodhojë dhe furnizojë një gamë të gjerë automjesh të specializuara, përfshirë: - Automjete të blinduara ushtarake, si MRAP, ATP, automjete për reagim të shpejtë. - Automjete për kontroll turmash dhe trazirash, si dhe për zbatimin e rendit publik. - Ambulanca (standard dhe të blinduara). - Kamionë logjistikë ushtarakë dhe platforma transporti - Automjete zjarrfikëse dhe të shpëtimit, për përdorim civil dhe ushtarak; - Çdo automjet të personalizuar me mbrojtje balistike. Shoqëria mund të angazhohet gjithashtu në kërkim, zhvillim, prototipizim dhe projekte të përbashkëta në fushën e mbrojtjes ose sigurisë, duke përfshirë menaxhimin e kontratave, granteve dhe tenderëve në nivel kombëtar ose ndërkombëtar. Lista e produkteve që Shoqëria do të prodhojë dhe tregtojë mund të përcaktohet më tej dhe përditësohet në Planin e Biznesit të miratuar nga aksionarët, dhe ndryshimet në këtë listë do të miratohen sipas mekanizmave vendimmarrës të Shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë edhe veprimtari të tjera ndihmëse ose plotësuese që lehtësojnë arritjen e objektivave të mësipërm, si p.sh.: - ngritjen e degëve, zyrave rajonale, agjencive ose njësisve të tjera brenda ose jashtë vendit, sipas nevojës; - lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit tregtar, partneriteti apo ortakërie me persona apo subjekte të tjera, për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë ose realizimin e objektivave të saj; - aplikimin dhe sigurimin e licencave, lejeve, autorizimeve dhe privilegjeve të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë; - çdo veprimtari tjetër që lejohet nga ligji dhe që Shoqëria e konsideron të favorshme për realizimin e objektivave të saj.

## II. Transaksioni

Transaksioni i propozuar lidhet me krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët (JV) me funksione të plota, e cila do të kontrollohet bashkërisht nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK. Pas marrëveshjes ndërmjet palëve, KAYO do të zotërojë XX% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët, ndërsa TIMAK SHPK do të zotërojë XX%. Kjo strukturë pronësie është në përputhje me Vendimin

e Këshillit të Ministrave nr. 322, datë 11.06.2025, i ndryshuar, që autorizon krijimin e shoqërisë së përbashkët, dhe është formalizuar në Marrëveshjen e Aksionarëve të datës 04.08.2025 (vlerësuar sekret tregtar i cili nuk është paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës).

Organet drejtuese të JV-së do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratori, në përputhje me ligjin dhe marrëveshjen ndërmjet palëve. Këshilli i Administrimit do të përbëhet nga 4 anëtarë, të emëruar nga të dy aksionarët, dhe vendimet e rëndësishme do të kërkojnë miratimin e përbashkët të KAYO SHA dhe TIMAK SHPK. Vendimet strategjike kyçe të Shoqërisë do të merren me shumicë të cilësuar ose unanimitet, çka u jep të dy aksionarëve të drejtën e vetos për çështjet e rëndësishme. Çështjet që kërkojnë miratim nga të dy aksionarët (të ashtuquajturat “Çështje të Rezervuara”), qoftë në Asamblenë e Përgjithshme ose në Këshillin e Administrimit, përfshijnë ndër të tjera: miratimin e buxhetit vjetor, planit të biznesit dhe planeve të investimit të Shoqërisë; emërimin apo shkarkimin e Administratorit të Shoqërisë, si dhe caktimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit; çdo ndryshim në kapitalin aksionar, emetimin e aksioneve të reja, apo transformimin, bashkimin, ndarjen ose likuidimin e Shoqërisë; miratimin e investimeve madhore, marrëveshjeve të rëndësishme të bashkëpunimit ose licencimit, si dhe çdo kontratë jashtë veprimtarisë së zakonshme (p.sh. transferimi i aktiveve kryesore të Shoqërisë apo dhënia e garancive në favor të të tretëve).

Sa më sipër, KAYO SHA dhe TIMAK SHPK do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi Shoqërinë e re TIMAK DEFENCE SHA.

Shoqëria e re TIMAK DEFENCE SHA do të kryejë në mënyrë të pavarur të gjitha funksionet kryesore të një subjekti tregtar autonom në tregun e saj (prodhim, shitje, blerje inputesh, shërbime mbështetëse, etj.), me kapacitete të qëndrueshme e afatgjata, të ndara nga ato të palëve themeluese. JV-ja do të ketë burime të mjaftueshme për një prani të pavarur në treg, të ndara nga shoqëritë mëmë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 322/2025, i ndryshuar, të miratuar në zbatim të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 88/2024 “Për krijimin e shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, aktiviteti i JV-së do të fillojë sa më shpejt, sepse ka një afat 3 vjeçar për të arritur qëllimet tregtare dhe të investimit.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të automjeteve motorike të posaçme, të blinduara

ushtarake, për përdorim institucional (nga Forcat e Armatosura, policia, agjencitë e emergjencave, etj.) dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK.

Palët në transaksion, shoqëria KAYO SHA ka për objekt aktiviteti projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake dhe aktiviteti ekonomik i TIMAK SHPK ka qenë i fokusuar në prodhimin/përshtatjen e komponentëve dhe konstruksioneve për makina të ndryshme ose përshtatjen/riparimin e mjeteve të veçanta (përfshirë mjete komerciale ose specialë civilë) dhe, në raste të caktuara, importin/furnizimin e mjeteve të posaçme (p.sh. ambulanca, kamionë zjarrfikës, automjete logjistike) përmes kontratave tregtare.

Ndërmarrja e përbashkët TIMAK DEFENCE SHA do të ketë si objekt aktiviteti prodhimin ose përshtatjen e mjeteve motorike të posaçme, me një arkitekturë të hapur që lejon instalimin e sistemeve të armatimit, siç janë armët automatike, sistemet e artilerisë, pajisjet antidron, mbrojtje aktive e mjetit, pajisje për përdorim urban dhe çdo sistem tjetër që kërkohet nga forcat e armatosura apo struktura të tjera të sigurisë, për t'u përdorur nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, strukturat e sigurisë dhe të emergjencave civile dhe klientë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë. JV-ja do të krijohet me qëllim kombinimin e përpjekjeve komplementare të palëve (kapital shtetëror dhe privat) në një veprimtari të re prodhuese.

Nga sa më sipër, konstatohet se transaksioni i krijimit të shoqërisë së përbashkët TIMAK DEFENCE SHA nuk do të krijojë mbivendosje horizontale e vertikale të aktivitetit të palëve në transaksion. Krijimi i shoqërisë TIMAK DEFENCE SHA pritet të shtojë kapacitete të reja prodhuese vendase në industrinë e mbrojtjes, pa shkaktuar efekte negative në konkurrencë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota TIMAK DEFENCE SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe TIMAK SHPK.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1220, Datë 10.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË  
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA M.K.D SHA NGA  
SHOQËRITË KAYO SHA DHE MSSC SHPK.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota të shoqërisë M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar palët në marrëveshje janë:

**Pala 1: KAYO SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Shoqëria ka objekt veprimtarie projektimin, prodhimin, riparimin,

demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake. Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria ndjek gjithashtu interesa ekonomike dhe tregtarë. Objektivat kryesore të aktivitetit të Shoqërisë janë, si më poshtë: a) projektimi, prodhimi, riparimi, demilitarizimi, asgjësimi dhe tregtimi, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake; b) ngritja, zhvillimi dhe forcimi i industrisë së prodhimit e të tregtimit të armëve, me qëllim sigurimin e nevojave të Forcave të Armatosura dhe ato të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të realizimit të fitimit ekonomik; c) prodhimi dhe furnizimi me për pajisje të nevojshme Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e interesave kombëtare; ç) ndërtimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve vendase për të prodhuar e furnizuar Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë me pajisje të nevojshme për operacionet e tyre; d) mobilizimi i kapitalit shtetëror dhe/ose privat në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj; dh) nxitja e investimeve në teknologji dhe inovacion për prodhimin, përdorimin, tregtimin e armëve brenda dhe jashtë vendit; e) bashkëpunimi me subjekte të ndryshme shtetërore e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e objektit të veprimtarisë së saj; ë) financimi ose bashkëfinancimi i projekteve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike të ngritura për realizimin e tyre. (2) Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet me aktivitetin e saj. Kjo përfshin gjithashtu edhe të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Aksionar i kësaj shoqërie është Ministria e Mbrojtjes me 100% të aksioneve.

Në tregun e brendshëm, shoqëria KAYO SHA zotëron paketën kontrolluese në shoqëritë TIMAK DEFENCE SHA dhe GUNA TACTICAL SHA, shoqëri aksionare, të regjistruara në përputhje me ligjin shqiptar.

**Pala 2: MSSC SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: Uniforma për ushtrinë dhe policinë, pajisje ndihmëse për policinë dhe ushtrinë, sisteme alarmi, vëzhgimi GPS, Dylbi dhe shënjestra holografike, si dhe të gjitha pajisjet ndihmëse, aparate rezistente kundra shpërthimeve, thyerjeve dhe dëmtimeve. Pajisje Antiplumb, pajisje elektronike të të gjitha llojeve, pranga, shkopinj gome, aparaturo të ndryshme survejimi, si dhe çdo aksesori tjetër të nevojshëm për policinë dhe ushtrinë. Import dhe tregtim të materialeve të gjuetisë, përfshirë edhe materialet me përdorim të 2-fishtë. Import-eksport të të gjitha mallrave

ushtarake duke përfshirë municionet dhe të gjitha llojet e armatimeve. Import eksport dhe tregtim të armëve, pjesëve dhe municioneve të kategorive "B1" "B4" "C" dhe "D". Qendër trajnimi për aftësimin teorik dhe praktik të personave për mbajtjen e armës. Qendër e Trajnimit Privat të punonjësve të "SHPSF". Transporti i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive "B1" , "B4", "C" "D". Poligon Civil Qitje i Mbyllur dhe pikë rekreative (bar -kafe) në funksion të tij. Poligon Civil Qitje i Hapur dhe me Pjatel dhe pikë rekreative (bar-restorant-pishinë) në funksion të tij, si dhe çdo aktivitet tjetër ndihmës për të përmbushur dhe realizuar objektin e shoqërisë. Prodhimi, magazinimi, transporti dhe tregtimi, projektimi, montimi, riparimi dhe demilitarizimi i armatimit ushtarak. Prodhimi dhe tregtimi i uniformave të policisë dhe ushtrisë të kompletuara me të gjithë komponentët e saj. Import, eksport, tregtim dhe transferim ndërkombëtar i mallrave ushtarake, si dhe çdo aktivitet tjetër në zbatim të ligjit.

Aksionar i kësaj shoqërie është z. Emiljano Dusha me 100% të aksioneve.

**Ndërmarrja e Përbashkët (JV) M.K.D SHA:** Ndërmarrja e përbashkët është një shoqëri aksionare, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me objekt aktiviteti: Prodhimi dhe tregtimi i municioneve të kalibrave të vegjël dhe të mesëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe objektivat e parashikuara në aktet normative për krijimin e shoqërisë. Kjo përfshin prodhimin dhe tregtimin e municioneve për Forcat e Armatosura dhe për struktura të tjera të sigurisë. Lista e produkteve që shoqëria do të prodhojë dhe tregtojë do të përditësohen në Planin e Biznesit të miratuar nga aksionarët dhe ndryshimet në këtë listë do të miratohen sipas mekanizmave vendimmarrës të shoqërisë, etj. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tregtare a financiare që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj, si më sipër. Aksionar i kësaj shoqërie është shoqëria KAYO SHA me XX% të aksioneve dhe MSSC SHPK më XX% të aksioneve.

## **II. Transaksioni**

Transaksioni i propozuar lidhet me krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët (JV) me funksione të plota, e cila do të kontrollohet bashkërisht nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK. Pas marrëveshjes midis palëve KAYO SHA do të zotërojë XX% të aksioneve të M.K.D SHA. dhe MSSC SHPK XX% të aksioneve. Kjo strukturë pronësie është në përputhje me autorizimin e dhënë nga Qeveria (VKM nr. 386/2025) dhe është formalizuar në Marrëveshjen e Aksionarëve të datës 01.08.2025 ndërmjet KAYO dhe MSSC. (vlerësuar sekret tregtar i cili nuk është paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës).

Ndërmarrja e përbashkët M.K.D SHA do të ketë organet drejtuese të parashikuara nga ligji: Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, Bordin e Administrimit dhe Administratorin. Bordi i Administrimit do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të emëruar me marrëveshjen e përbashkët të aksionarëve, duke siguruar përfaqësim të të dy palëve. Vendimet kyçe strategjike të shoqërisë do të merren me shumicë të cilësuar ose në mënyrë unanime, çka u jep të dy aksionarëve të drejtën e vetos për çështjet e rëndësishme. Në veçanti, çështjet e rezervuara që kërkojnë miratimin e të dy aksionarëve (KAYO dhe MSSC) përfshijnë, ndër të tjera:

- miratimin e buxhetit vjetor, planit të biznesit dhe planeve të investimit të shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e Administratorit të shoqërisë, si dhe caktimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit;
- çdo ndryshim në kapitalin aksionar, emetimin e aksioneve të reja, apo transformimin, bashkimin, ndarjen apo likuidimin e shoqërisë;
- miratimin e investimeve madhore, marrëveshjeve të bashkëpunimit ose të licencimit, si dhe çdo kontratë jashtë veprimtarisë së zakonshme (p.sh. transferimi i aktiveve kryesore të shoqërisë apo dhënia e garancive ndaj të tretëve).

Sa më sipër, KAYO SHA dhe MSSC SHPK do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi ndërmarrjen e përbashkët (JV).

Në funksion të objektivave të saj, M.K.D SHA do të ngrihet me kapacitete të plota prodhuese dhe logjistike, duke synuar të arrijë pavarësinë operationale sa më shpejt të jetë e mundur, si dhe duke zhvilluar kapacitetin e vet prodhues, rrjetin e furnizimit dhe kanalet e marketingut drejt klientëve institucionalë.

Ndërmarrja e përbashkët do të disponojë asetet dhe infrastrukturën e nevojshme për veprimtarinë e saj, do të pajiset me linjat teknologjike të prodhimit, makineri e pajisje të avancuara sipas standardeve të kërkuara (të cilat do të blihen dhe instalohen në përputhje me Planin e Biznesit). Pas funksionalizimit të plotë, JV-ja do të kryejë vetë të gjithë procesin: nga projektimi dhe prodhimi i uniformave e aksesorëve ushtarakë, deri te paketimi, shpërndarja dhe eksporti i tyre, pa u varur në funksionet e shoqërive mëmë. M.K.D SHA do të kryejë në mënyrë të pavarur të gjitha funksionet e një subjekti ekonomik autonom, në bazë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për prodhimin dhe tregtimin e municioneve të kalibrave të vegjël dhe të mesëm për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe strukturat e tjera të sigurisë dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

KAYO SHA është një shoqëri shtetërore e re dhe deri në momentin e njoftimit nuk ka ushtruar veprimtari prodhuese apo tregtare konkrete në tregun e municioneve të kalibrave të vegjël/mesëm. KAYO ka qenë kryesisht aktive në krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta për realizimin e

objektivave strategjikë. Si e tillë, KAYO nuk ka as pjesë tregu dhe as rol konkurrenti në këtë treg. MSSC SHPK deri më sot nuk ka prodhuar municione në Shqipëri. Aktiviteti i MSSC në këtë sektor ka qenë importi dhe furnizimi/distribuimi i municioneve të gatshme (dhe i pajisjeve të tjera ushtarake) përmes kontratave tregtare e tenderëve. Pra, MSSC ka vepruar si ndërmjetës tregtar, jo si prodhues i municioneve. Rrjedhimisht, MSSC nuk është aktiv në të njëjtin treg produkti si M.K.D SHA.

Sipas deklaratës së Palëve, ndërmarrjet mëma nuk janë aktive në të njëjtin treg e për rrjedhojë nuk ka asnjë bazë për të konsideruar se krijimi i M.K.D SHA do të shkaktojë koordinim të sjelljes konkurruese midis MSSC dhe KAYO. JV-ja është krijuar me qëllim kombinimin e përpjekjeve komplementare të palëve (kapital shtetëror dhe privat) në një veprimtari të re prodhuese, dhe nuk do të lehtësojë asnjë shkëmbim informacioni apo marrëveshje të fshehtë ndërmjet palëve në ndonjë treg tjetër. Çdo ndërveprim midis MSSC dhe KAYO do të kufizohet në kuadër të ndërmarrjes së përbashkët dhe do të monitorohet nga struktura e qeverisjes së saj, në përputhje me ligjin.

Për pasojë, ky përqendrim mund të konsiderohet i padëmshëm për konkurrencën pasi ai nuk eliminon asnjë konkurrent aktual dhe nuk krijon rrezik koordinimi midis palëve, por shton një konkurrent të ri (JV-në) në tregun përkatës.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota M.K.D SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1221, Datë 10.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR KRIJIMIN E NJË  
NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA GUNA TACTICAL SHA  
NGA SHOQËRITË KAYO SHA DHE MSSC SHPK.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota të shoqërisë GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota të shoqërisë GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar palët në marrëveshje janë:

**Pala 1: KAYO SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Shoqëria ka objekt veprimtarie projektimin, prodhimin, riparimin, demilitarizimin, asgjësimin dhe tregtimin, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve

ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, të municioneve, të teknologjive dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake. Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria ndjek gjithashtu interesa ekonomike dhe tregtarë. Objektivat kryesore të aktivitetit të Shoqërisë janë, si më poshtë: a) projektimi, prodhimi, riparimi, demilitarizimi, asgjësimi dhe tregtimi, brenda dhe jashtë vendit, të të gjitha llojeve të armëve ose pjesëve të armëve, përfshirë edhe armët ushtarake, municioneve, teknologjitë dhe pajisjeve ushtarake, uniformat, mjetet, pajisjet dhe sistemet e armatimit e komunikimit, si dhe çdo aktivitet të lidhur me këtë veprimtari, në funksion të politikave kombëtare të sigurisë e mbrojtjes dhe rritjes së kapaciteteve ushtarake; b) ngritja, zhvillimi dhe forcimi i industrisë së prodhimit e të tregtimit të armëve, me qëllim sigurimin e nevojave të Forcave të Armatosura dhe ato të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si dhe të realizimit të fitimit ekonomik; c) prodhimi dhe furnizimi me për pajisje të nevojshme Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e interesave kombëtare; ç) ndërtimi, zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve vendase për të prodhuar e furnizuar Forcat e Armatosura dhe strukturat e tjera përgjegjëse të sigurisë me pajisje të nevojshme për operacionet e tyre; d) mobilizimi i kapitalit shtetëror dhe/ose privat në funksion të zhvillimit të aktivitetit të saj; dh) nxitja e investimeve në teknologji dhe inovacion për prodhimin, përdorimin, tregtimin e armëve brenda dhe jashtë vendit; e) bashkëpunimi me subjekte të ndryshme shtetërore e private, kombëtare dhe ndërkombëtare, për zhvillimin e objektit të veprimtarisë së saj; ë) financimi ose bashkëfinancimi i projekteve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare ose shoqëri të themeluara në bashkëpunim me subjekte private dhe/ose publike të ngritura për realizimin e tyre. (2) Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet me aktivitetin e saj. Kjo përfshin gjithashtu edhe të drejtën të krijojë struktura të tjera sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Aksionar i kësaj shoqërie është Ministria e Mbrojtjes me 100% të aksioneve.

Në tregun e brendshëm, shoqëria KAYO SHA zotëron paketën kontrolluese të shoqërive TIMAK DEFENCE SHA dhe M.K.D SHA, shoqëri aksionare, të regjistruara në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Pala 2: MSSC SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Import-eksport, tregtimin e artikujve të ndryshëm të gjitha llojeve, me shumicë e pakicë si: Uniforma për ushtrinë dhe policinë, pajisje ndihmëse për policinë dhe ushtrinë, sisteme alarmi, vëzhgimi GPS, Dylbi dhe shënjestra holografike, si dhe të gjitha pajisjet ndihmëse, aparate rezistente kundra shpërthimeve, thyerjeve dhe dëmtimeve. Pajisje Antiplumb, pajisje elektronike të të gjitha llojeve, pranga, shkopinj gome, aparaturo të ndryshme survejimi, si dhe çdo aksesor tjetër të nevojshëm për policinë dhe ushtrinë. Import dhe tregtim të materialeve të gjuetisë, përfshirë edhe materialet me përdorim të 2-fishtë. Import-eksport të të gjitha mallrave ushtarake duke përfshirë municionet dhe të gjitha llojet e armatimeve. Import eksport dhe tregtim

të armëve, pjesëve dhe municioneve të kategorive "B1" "B4" "C" dhe "D". Qendër trajnimi për aftësimin teorik dhe praktik të personave për mbajtjen e armës. Qendër e Trajnimit Privat të punonjësve të "SHPSF". Transporti i armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive "B1", "B4", "C" "D". Poligon Civil Qitje i Mbyllur dhe pikë rekreative (bar -kafe) në funksion të tij. Poligon Civil Qitje i Hapur dhe me Pjatel dhe pikë rekreative (bar-restorant-pishinë) në funksion të tij, si dhe çdo aktivitet tjetër ndihmës për të përmbushur dhe realizuar objektin e shoqërisë. Prodhimi, magazinimi, transporti dhe tregtimi, projektimi, montimi, riparimi dhe demilitarizimi i armatimit ushtarak. Prodhimi dhe tregtimi i uniformave të policisë dhe ushtrisë të kompletuara me të gjithë komponentët e saj. Import, eksport, tregtim dhe transferim ndërkombëtar i mallrave ushtarake, si dhe çdo aktivitet tjetër në zbatim të ligjit.

Aksionar i kësaj shoqërie është z. Emiljano Dusha me 100% të aksioneve.

**Ndërmarrja e Përbashkët (JV) GUNA TACTICAL SHA:** Ndërmarrja e përbashkët është një shoqëri aksionare, në përputhje me ligjin shqiptar, me objekt aktiviteti: Projektimi, prodhimi, përpunimi, magazinimi, paketimi, promovimi, shpërndarja, tregtimi dhe eksportin e uniformave ushtarake dhe aksesoreve për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për strukturat e tjera të sigurisë dhe klientë të tjerë vendas apo ndërkombëtarë. Kapitali i shoqërisë do të jetë në shumën prej 35,000 Euro, dhe kontribute shtesë në kapital mund të bëhen nga palët me anë të kontributeve në natyrë në rezervën e kapitalit dhe/ose nëpërmjet investimeve të ortakëve.

Aksionar i kësaj shoqërie është shoqëria KAYO SHA me XX% të aksioneve dhe MSSC SHPK me XX% të aksioneve. JV-ja do të kryejë në mënyrë të pavarur të gjitha funksionet e një subjekti ekonomik autonom, në bazë të qëndrueshme dhe afatgjatë. JV-ja do të ketë burime të mjaftueshme për një prani të pavarur në treg, të ndara nga shoqëritë mëmë, e cila do të krijohet për një periudhë afatgjatë dhe pa afat të caktuar, ndaj do të operojë mbi baza të qëndrueshme.

## II. Transaksioni

Transaksioni i propozuar lidhet me krijimin e një sipërmarrjeje të përbashkët (JV) me funksione të plota, e cila do të kontrollohet bashkërisht nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK. Pas marrëveshjes ndërmjet palëve, KAYO do të zotërojë XX% të aksioneve të shoqërisë së përbashkët, ndërsa MSSC SHPK do të zotërojë XX%. Kjo strukturë pronësie është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 28.05.2025, që autorizon krijimin e shoqërisë së përbashkët, dhe është formalizuar në Marrëveshjen e Aksionarëve të datës 04.08.2025 (vlerësuar sekret tregtar i cili nuk është paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës).

Ndërmarrja e përbashkët GUNA TACTICAL SHA do të ketë organet drejtuese të parashikuara nga ligji: Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve, Bordin e Administrimit dhe Administratorin. Bordi i Administrimit do të përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të emëruar me marrëveshjen e përbashkët të aksionarëve, duke siguruar përfaqësim të të dy palëve. Vendimet kyçe strategjike të shoqërisë do të merren me shumicë të cilësuar ose në mënyrë unanime, çka u jep të dy aksionarëve të drejtën e vetos për çështjet e rëndësishme. Në veçanti, çështjet e rezervuara që kërkojnë

miratimin e të dy aksionarëve (KAYO dhe MSSC) përfshijnë, ndër të tjera:

- miratimin e buxhetit vjetor, planit të biznesit dhe planeve të investimit të shoqërisë;
- emërimin ose shkarkimin e Administratorit të shoqërisë, si dhe caktimin e anëtarëve të Bordit të Administrimit;
- çdo ndryshim në kapitalin aksionar, emetimin e aksioneve të reja, apo transformimin, bashkimin, ndarjen apo likuidimin e shoqërisë;
- miratimin e investimeve madhore, marrëveshjeve të bashkëpunimit ose të licencimit, si dhe çdo kontratë jashtë veprimtarisë së zakonshme (p.sh. transferimi i aktiveve kryesore të shoqërisë apo dhënia e garancive ndaj të tretëve).

Sa më sipër, KAYO SHA dhe MSSC SHPK do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi ndërmarrjen e përbashkët (JV).

Ndërmarrja e përbashkët nuk do të kufizohet vetëm në kryerjen e një funksioni të vetëm të marrë nga mëmat (p.sh. nuk do të jetë thjesht një agjent shitjesh apo një njësi prodhimi për njërën palë), por do të krijojë një zgjidhje të re të integruar në treg, e cila deri më tani nuk ofrohej as nga MSSC SHPK dhe as nga KAYO SHA individualisht.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 28 maj 2025 , të miratuar në zbatim të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 88/2024 “Për Miratimin e Kushteve të Negocimit të Shoqërisë Shtetërore KAYO SHA , me shoqëri Private për Prodhimin dhe Tregtimin e Uniformave Ushtarake dhe Aksesoreve”, aktiviteti do të fillojë sa më shpejt si rrjedhë e një afati 3 vjeçar për të arritur qëllimet tregtare dhe të investimit.

Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota të shoqërisë GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe furnizimit të uniformave dhe aksesoreve ushtarakë për forcat e armatosura dhe struktura të tjera të sigurisë dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e shoqërisë GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.

Shoqëria KAYO, si shoqëri shtetërore e themeluar në vitin 2024, nuk ka operuar në tregun e uniformave apo pajisjeve të tekstilit ushtarak. Ajo ka një objekt të gjerë ligjor që përfshin prodhimin dhe tregtimin e teknologjive ushtarakë, por nuk ka pasur ndonjë aktivitet në këtë segment para krijimit të JV-së. Një nga objektivat e saj është të krijojë shoqëri të përbashkëta që

operojnë si shoqëri më vetë të pavarura, me partnerë privatë për qëllime të ndryshme sipas objektit të saj tregtar.

MSSC ka qenë importues dhe furnizues i uniformave të gatshme dhe aksesorëve ushtarakë, por nuk ka zhvilluar veprimtari prodhuese në këtë sektor në Shqipëri, duke mos qenë aktiv në të njëjtin treg të produktit si JV-ja. Roli i saj ka qenë ekskluzivisht si distributor dhe jo si prodhues i uniformave.

Asnjëra nga shoqëritë mëmë, MSSC dhe KAYO, nuk ka operuar në të njëjtin treg me ndërmarrjen e përbashkët GUNA TACTICAL dhe nuk zhvillojnë veprimtari në tregje të afërta.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota GUNA TACTICAL SHA nga shoqëritë KAYO SHA dhe MSSC SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1222, Datë 29.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAST FOOD ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA KAN ALBANIA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar mbi përfitimën e kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitimit të kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitimën e kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK.
2. Referuar dokumenteve [\_\_\_\_\_].

**II. Përqendrimi**

3. [\_\_\_\_\_].
4. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitimën e kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK, duke plotësuar kriteret e

parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

5. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet [\_\_\_\_\_].
6. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK.
7. [\_\_\_\_\_].

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Fast Food Albania SHPK nga shoqëria KAN ALBANIA SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1223, Datë 29.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË HEAVEN BEACH SHPK NGA SHOQËRIA 4 A-M SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë ILIRIADA SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i propozuar i përfimit të kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.
2. Referuar dokumentit “Kontratë Shitje Kuote Kapitali”, palët në marrëveshje janë:
3. **Pala Blerëse: 4 A-M SHPK** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislationit shqiptar. Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj; Punime elektrike, tregtim me shumicë e pakicë të materialeve elektrike, import eksportin e tyre, prodhim dhe tregtim betoni dhe inerte, tregtim me shumicë dhe me pakicë, import-eksport të artikuljeve të ndryshëm industrial, ushqimore, elektroshtëpiake, konfeksione, kozmetike. Tregtim dhe

shitje produktesh artizanati, kimike, tekstile, artikuj plastike. Tregtim produktesh të gatshme me shumicë e pakicë, etj. Në fushën e ndërtimit, të ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, mbi 2 kate dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Në fushën e projektimit dhe zbatimin duke përfshirë, por pa u kufizuar, i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhore, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike, topografike dhe hidrologjike, inxhinierike të impianteve të prodhimit dhe transmetimit të energjisë etj.

4. Shoqëria 4 A-M SHPK, zotëron kuota në shoqëritë MD green energy SHPK; O-SP Albania SHA; GREEN ENERGY PLUS SHPK dhe ILIRIADA SHPK.
5. **Pala Shitëse: Znj. Antoneta Maksakuli dhe Znj. Maria Maksakuli**, shtetase shqiptare, zotëruese secila të 50 % të kapitalit të shoqërisë target.
6. **Shoqëria Target: HEAVEN BEACH SHPK**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Projektim, zhvillim dhe realizim punimesh ndërtimore të çdo lloji për objekte civile, industriale, bujqësore, turistike dhe infrastrukturore. Ndërtim, rikostruksion dhe mirëmbajtje objektesh banimi, shërbimi, hotelerie, magazinash, kapanonesh, strukturash turistike dhe agroturistike. Kryerje e instalimeve elektrike, hidraulike, sistemimeve të terrenit dhe punime të ndihmëse. Tregtim me pakicë dhe shumicë, si dhe import-eksport të materiale të ndërtimit. Zhvillimi i aktivitetit në fushën e turizmit dhe hotelerisë, përfshirë ndërtimin dhe administrimin e strukturave akomoduese si hotele, bujtina, resorte, vila turistike dhe agroturizëm. Organizim paketash turistike dhe kulturore, akomodim, bar-restorant dhe çdo veprimtari mbështetëse në funksion të turizmit.

## II. Përqendrimi

7. Më datë [\_\_\_\_\_] është nënshkruar dokumenti “Kontratë Shitje Kuote Kapitali” ndërmjet shoqërisë 4 A-M SHPK (në cilësinë e blerësit) dhe znj. Antoneta Maksakuli dhe znj. Maria Maksakuli (në cilësinë e shitësve).
8. Referuar nenit 1 të kontratës, objektit të kontratës është shitja me rezerve e 2 (dy) kuotave, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit, që zotërojnë ortakët znj. Antoneta Maksakuli dhe znj. Maria Maksakuli tek blerësi, shoqëria 4 A-M SHPK, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
9. Referuar Kontratës evidentohet se: kapitali i shoqërisë është [\_\_\_\_\_].
10. Kontrata merr fuqi ligjore me [\_\_\_\_\_] dhe pas kësaj pala blerëse shoqëria 4 A-M SHPK do të jetë ortaku i vetëm i shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK.
11. Transaksioni i propozuar i përfundimit të kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### III. Analiza e Konkurrencës

12. Bazuar në nenin 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ndërtimit, duke përfshirë ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje objekte banimi, shërbimi, hoteleri në funksion të turizmit. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i rrethit të Sarandës.
13. Referuar pasqyrave financiare të shoqërisë 4 A-M SHPK për vitin 2024, u evidentua se aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është punime & instalime elektrike, tregtim imp-exp materialesh, ndërtim, projektim i pakufizuar i veprave urbane dhe civile etj. Nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, 4 A-M ka prezencë edhe në tregun e importit, transportit, tregtimit dhe magazinimit të vajrave lubrifikante, si dhe synon futjen në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.
14. Shoqëria target është një shoqëri e re, e cila ka objekt aktivitetin në tregun e ndërtimit duke përfshirë ndërtim, rikonstruksion dhe mirëmbajtje objekte banimi, shërbimi, hoteleri në funksion të turizmit, por e fokusuar aktualisht në zhvillimin e kapitalit të shoqërisë, hoteli në Çukë, në Sarandë.
15. Pala njoftuese ka deklaruar se realizimi i transaksionit do të sjellë mundësinë e rritjes së investimeve të shoqërisë 4 A-M në fushën e turizmit, duke sjellë përmirësim të infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve të shërbimeve në ndërtim dhe turizëm.
16. Transaksioni i propozuar përbën një përqendrim horizontal, duke krijuar mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun e ndërtimit, por shoqëria target është e sapokrijuar dhe për më tepër godina që përfaqëson kapitalin e saj ka ofruar shërbim hoteleri vetëm gjatë sezonit turistik dhe përfitimi i kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nuk pritet të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të shoqërisë 4 A-M SHPK..

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitimin e kontrollit të shoqërisë HEAVEN BEACH SHPK nga shoqëria 4 A-M SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1224, Datë 29.10.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË IE – ENERGY PROJEKT D.D. NGA SHOQËRITË BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, RAIFFEISEN DRUŠTVO ZA UPRAVLJANJE OBVEZNM I DOBROVOLJNIM MIROVINSKIM FONDOVIMA D.D. DHE IND – EKO PLUS D.O.O.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:**

Autorizimi i përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.

**Baza Ligjore:**

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.
2. Referuar dokumenteve “Marrëveshje Abonimi” dhe “Marrëveshja e Aksionarëve”, nënshkruar më datë [\_\_\_\_], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi 1: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)** është një bankë shumëpalëshe zhvillimi, e themeluar në bazë të një traktati ndërkombëtar, Marrëveshjes për Themelimin e BERZHIT, e ndryshuar. Shqipëria është një nga shtetet anëtarë të BERZHIT.
4. BERZH është një institucion financiar ndërkombëtar që mbështet zhvillimin e ekonomive të tregut përmes investimeve tregtare. Aktiviteti i saj përfshin financimin e projekteve të sektorit privat duke ofruar kredi, investime në kapital dhe garanci. Banka investon në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë infrastrukturën, energjinë, prodhimin, bujqësinë dhe financën.
5. BERZH nuk ka filiale në Shqipëri. [\_\_\_\_].
6. **Blerësi 2: Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. (RMF)** specializohet në menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare të pensioneve në Kroaci. Aksionari i vetëm i RMF është shoqëria Raiffeisenbank Austria d.d., i cili është i zotëruar plotësisht në mënyrë indirekte nga Raiffeisen Bank International AG (RBI). [\_\_\_\_].
7. **Shitësi: IND - EKO Plus** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Kroacisë, e cila ofron shërbime për trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbetjeve industriale, rehabilitimin e tubave pa kanale dhe mbrojtjen e mjedisit duke përdorur pajisjet dhe teknologjitë e veta.
8. Shitësi aktualisht zotëron 100% të kuotave të shoqërisë target IE -ENERGY PROJEKT d.d.
9. Shitësi nuk ka aktivitet dhe prezencë ligjore në Shqipëri.
10. **Shoqëria Target: IE – ENERGY PROJEKT d.d.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Kroacisë, një shoqëri *holding* e re, e themeluar me qëllim që vetëm të zotërojë kuota në subjekte të tjera (pa aktivitete biznesi të vetat).
11. IE – ENERGY PROJEKT d.d. zotëron 100% shoqërinë IE - ENERGY d.o.o., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, e cila do të zhvillojë dhe ndërtojë një sistem të ruajtjes së energjisë në bateri deri më 60MW dhe një Termocentral Virtual në Šibenik, Kroaci.
12. Asetet e shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.o.o. do të operohen nga shoqëria NGEN Smart Energy Systems d.o.o. për qëllime të tregtimit të energjisë elektrike. NGEN Smart Energy

Systems d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe ekzistuese sipas legjislacionit të Kroacisë dhe pjesë e Grupit NGEN.

## II. Përqendrimi

13. Ndërmjet shoqërive IE – ENERGY PROJEKT d.d. (shoqëria target), Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe Banka Evroplane për Rindërtim dhe Zhvillim (blerësit / investuesit) dhe IND – EKO PLUS d.o.o. (shitësi) është lidhur “Marrëveshje Abonimi”, nënshkruar më datë [\_\_\_\_\_].
14. Referuar kësaj marrëveshje, shoqëria synon të kryejë një projekt për investime në kapital në shoqëri me qëllim kryesor blerjen dhe / ose ndërtimin e asetëve (Projekti). Për qëllimin e financimit të Projektit, shoqëria synon të rrisë kapitalin e saj në dy faza të veçanta abonimi. Pas abonimit të parë, aksionarët e shoqërisë do të zotërojnë aksionet e emetuara dhe të papaguara të shoqërisë në përpjesëtimet: IND - EKO PLUS d.o.o. X%, BERZH X% dhe RMF X%. Pas abonimit të dytë, aksionarët e shoqërisë do të zotërojnë aksionet e emetuara dhe të papaguara të shoqërisë në përpjesëtimet: IND -EKO PLUS d.o.o. X%, BERZH X% dhe RMF X%.
15. Në po të njëjtën datë, shoqëritë IE – ENERGY PROJEKT d.d. (shoqëria target), Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe Banka Evroplane për Rindërtim dhe Zhvillim (blerësit / investuesit), IND – EKO PLUS d.o.o. (shitësi) dhe IE - ENERGY d.o.o. është lidhur dhe nënshkruar “Marrëveshja e Aksionarëve”.
16. Marrëveshja e Aksionarëve parashikon që disa vendime strategjike ne Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë target kërkojnë votën pro të secilit prej ortakëve, pavarësisht përqindjes së kapitalit. Këto vendime strategjike lidhën më një numër çështjesh që përfshijnë: i) ndryshimet në statutin e shoqërisë; ii) çdo rritje, ulje ose ndryshim tjetër në kapitalin aksionar të shoqërisë ose çdo ndryshim në të drejtat që i bashkëngjiten aksioneve; iii) çdo transformim, bashkim, ndarje, likuidim, riorganizim i shoqërisë etj.
17. Nga abonimi i dytë, vendimet e mëposhtme nga Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve do të kërkojnë votën pozitive të secilit aksionar në lidhje me çështjet e rezervuara si: i) ndryshimin e veprimtarisë kryesore tregtare; ii) emërimin, shkarkimin ose përcaktimin e shpërblimit të drejtorëve dhe anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës; iii) ndryshimin e strukturës dhe numrit të anëtarëve të organeve drejtuese; iv) emërimin apo shkarkimin e drejtorit ekzekutiv (CEO) etj.
18. Bordi Mbikëqyrës do të përbëhet nga 5 ose 7 anëtarë, ku BERZH do të ketë të drejtë të emërojë 1 person, RMF do të ketë të drejtë të emërojë 1 person (për aq kohë sa do të jenë ortakë në kapitalin e shoqërisë dhe pjesëmarrës në strukturën e pronësisë) dhe IND – EKO PLUS d.o.o. do të emërojë 2 persona, përfshirë kryetarin (për të shmangur çdo dyshim kryetari do të zgjidhet nga anëtarët e Bordit Mbikëqyrës në përputhje me ligjin). Në rast se Bordi do të jetë me 7

anëtarë, BERZH do të zgjedhë 1 anëtar, RMF 1 anëtar dhe IND – EKO PLUS d.o.o. do të emërojë 4 anëtarë. Çdo anëtar i Bordit Mbikëqyrës do të ketë një votë dhe vendimet e Bordit Mbikëqyrës do të merren më shumicën e thjeshtë të votave. Në rast bllokimi (në varësi të seksioneve të përcaktuara në marrëveshje) kryetari do të ketë një votë vendimtare.

19. Nga abonimi i parë deri në abonimin e dytë, çdo vendim i Bordit Mbikëqyrës në lidhje me ndonjë nga çështjet e listuara më poshtë (Çështjet e rezervuara të abonimit të parë), që kanë të bëjnë më shoqërinë target, do të kërkojnë pëlqimin e anëtarëve të emëruar nga secili aksionar: i) lindja e çdo borxhi financiar; ii) blerja, shitja ose pengu i çdo aksioni në çdo entitet tjetër; iii) kryerja e çdo shpenzimi në kapital ose shpenzim tjetër që tejkalon shumën prej 100,000 euro etj.
20. Nga abonimi i dytë, çdo vendim i Bordit Mbikëqyrës në lidhje me ndonjë nga çështjet e listuara më poshtë (Çështjet e rezervuara të abonimit të dytë), që kanë të bëjnë me shoqërinë target, do të kërkojnë pëlqimin e anëtarëve të emëruar nga secili prej aksionarëve: i) miratimi i buxhetit vjetor ose planit të biznesit; ii) emërimin, shkarkimin ose shpërblimin e menaxhmentit të lartë të shoqërisë target, iii) blerja, shitja ose pengu i çdo aksioni në çdo entitet tjetër, degë ose formimi i një dege të re etj.
21. Në përfundim të abonimit të dytë, BERZH dhe RMF do të zotërojnë së bashku X% në kapitalin e shoqërisë target dhe IND – EKO PLUS d.o.o. do të zotërojë X%.
22. Referuar shkresës nr. 761/5 prot. i AK, datë 10.10.2025 “Kërkesë lidhur me njoftimin mbi përqendrimin - Raiffeisen Mandatory and Voluntary Pension Funds Management Company Plc. Dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim”, është përcaktuar se shoqëria target si ortak i vetëm i shoqërisë IE - ENERGY d.o.o. dhe si ortak i ardhshëm me X% në NGEN Smart Energy Systems d.o.o., ushtron kontroll mbi filialet e saj përmes të drejtave të saj. Marrëveshja e Aksionarëve parashikon se disa prej çështjeve të rezervuara në nivelin e shoqërisë target të inkorporohen edhe në nivelin e filialeve dhe ushtrimi i të drejtave të shoqërisë target në IE - ENERGY d.o.o. dhe NGEN Smart Energy Systems d.o.o. të harmonizohet me Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë target, duke siguruar që çështjet e përshkruara më sipër të zbatohen edhe në nivelin e filialeve.
23. Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 77 është përcaktuar se: Një lëvizje nga një kontroll i vetëm në një kontroll të përbashkët konsiderohet si një transaksion që duhet njoftuar, duke qenë se kjo ndryshon cilësinë e kontrollit të joint venture. Së pari, ka një përfitim të ri të kontrollit për aksionarët që hyjnë në një ndërmarrje të kontrolluar. Së dyti, vetëm përfutuesit e rinj të kontrollit e bëjnë ndërmarrjen kontrolluese një joint venture, e cila ndryshon në mënyrë vendimtare situatën për ndërmarrjen kontrolluese që mbetet.
24. Investimi në kapital nëpërmjet nënshkrimit të pjesëmarrjes në kapital (aksioneve) nga investitorët / blerësit do të sjellë ndryshime në strukturën e pronësisë, të drejtat e

vendimmarrjes, qeverisjes dhe kontrollit të aksionarëve. Duke qenë se, në shoqërinë target IE – ENERGY PROJEKT d.d. kanë hyrë dy aksionarë të rinj kontrollues, BERZH, i cili do të zotërojë në vazhdim X% të kapitalit të shoqërisë target dhe RMF, i cili do të zotërojë në vazhdim X% të kapitalit të shoqërisë target, atëherë hyrja e këtyre aksionarëve të rinj në shoqërinë target, e cila kontrollohej më parë vetëm nga shoqëria IND – EKO PLUS d.o.o., përbën një ndryshim kontrolli.

25. Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë target IE – ENERGY PROJEKT d.d. do të kërkojnë votën pozitive të aksionarëve të rinj kontrollues BERZH dhe RMF, për vendime të rëndësishme strategjike të përcaktuara më sipër.
26. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

27. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ruajtjes dhe tregtimit të energjisë elektrike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
28. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.
29. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është një institucion financiar ndërkombëtar që mbështet zhvillimin e ekonomive të tregut përmes investimeve tregtare.
30. RMF është një shoqëri e specializuar në menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare të pensioneve në Kroaci dhe zotërohet në mënyrë indirekte nga Raiffeisen Bank International AG (RBI). RBI është e pranishme dhe ka realizuar xhiro në Shqipëri përmes filialeve të saj që operojnë në sektorin bankar dhe financiar, të cilat nuk kanë lidhje me tregun përkatës.
31. Shoqëria Target IE-ENERGY PROJEKT d.d. dhe filialet e saj, IE-ENERGY d.d. dhe NGEN Smart Energy Systems d.o.o. janë shoqëri kroate, aktivitetet e biznesit të të cilave do të

kufizohen vetëm në tregun kroat dhe asnjëra prej tyre nuk ka prezencë ligjore apo aktivitet në Shqipëri.

32. Transaksioni konsiston në zhvillimin dhe ndërtimin e një objekti, bateri për ruajtjen e energjisë deri në 60 MW në Kroaci, i cili do të zotërohet nga IE-ENERGY d.d. dhe do të operohet nga NGEN Smart Energy Systems d.o.o.
33. NGEN Smart Energy Systems do të ndërmarrë operimin/menaxhimin e objektit, baterisë për ruajtjen e energjisë si dhe tregtimin e energjisë elektrike.
34. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar mbi përfitimn e kontrollit të përbashkët të shoqërisë IE – ENERGY PROJEKT d.d. nga shoqëritë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Raiffeisen društvo za upravljanje obveznim i dobrovoljnim mirovinskim fondovima d.d. dhe IND – EKO PLUS d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1225, Datë 29.10.2025**

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË THELLUAR PËR TRANSAKSIONIN E PROPOZUAR TË PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TRING TV SHA NGA SHOQËRIA VERTEX HOLDING SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.
2. Referuar dokumentit “Kontratë Shitje dhe Blerje Aksionesh”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Vertex Holding SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e aktiviteteve të shoqërive holding. Shitblerje aksionesh. Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryej çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me

objektivin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajshme dhe të paluajshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i shoqërisë.

4. Ortak i vetëm i shoqërisë blerëse është z.Valon Shala me 100% të aksioneve, i cili ka deklaruar se nuk zotëron shoqëri të tjera si brenda territorit shqiptar dhe jashtë saj.
5. **Shitësi: CONCORD INVESTMENT SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe objekt aktiviteti: Investimi, zbatimi, zhvillimi, menaxhimi i zonave civile, industriale, turistike, si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to. Kryerja e veprimtarive tregtare në fushën e ndërtimit, për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndërtimit. Kryerja e aktivitetit për investimin në fushën e ndërtimit, në komplekse civile, turistike, industriale, sociale, komplekseve të tregtimit dhe të shërbimit bar-restorant-hoteleri etj. Pjesëmarrje në projekte ndërtimore, si sipërmarrës, investitor, konsulent, si dhe marrjen përsipër të menaxhimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjetër për ndërtim. Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Kontraktimi me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe punë të shoqërisë. Blerje-Shitje të pasurive të luajshme dhe të paluajshme (prona të ndryshme, si trojë, toka bujqësore, apartamente banimi, ambiente shërbimi dhe tregtimi etj., pasuri këto në pronësi të shoqërisë ose në pronësi të shoqërive të tjera, personave fizikë apo juridike, të cilët e autorizojnë për përfaqësim shoqërinë, për blerje-shitje.
6. Concord Investmen SHPK, kontrollohet nga ortakët Adrian Dulaku me 33,00% të aksioneve, Artan Dulaku me 34,00% të aksioneve, Genci Dulaku me 33,00% të aksioneve.
7. **Shoqëria Target: Tring TV SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Veprimtari ekskluzive audiovizive. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në ndërtimin e sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve audiovizive dhe ripërsëritjen e tyre në çdo lloji transmetimi (satelitor tokësor, kabllor, IPTV,OTT, Internet TV) në formë të koduar apo të pakoduar, me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, sateliteve apo me çdo mjet tjetër. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në tregtimin e aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së valëve audiovizive. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në ndërtimin dhe shfrytëzimin e rrjeteve numerike, për transmetimin satelitor, tokësor, kabllor IPTV, OTT, Internet TV me qëllim ofrimin e shërbimit të transmetimit për publikun. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive

audiovizive ushtron dhe veprimtari në prodhimin, transmetimin, ritransmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve dhe shërbimeve audio e video. etj.

8. Shoqëria target kontrollohet drejtpërdrejt nga shoqëria Concord Investmen SHPK me 100% të aksioneve.
9. Shoqëria Tring Tv SHA është e licencuar nga AMA me certifikatën Nr. 2012-AP-U233-8-3 15.05.2012 dhe Nr. 2014-AP-U233-8-3 06.02.2015 për: -Shërbime publike të komunikimeve elektronike; -Shërbime të tjera të komunikimeve elektronike; - Shërbimet me vlerë të shtuar; - Mesazhe zanore/jozanore; - Rrjete publike me transmetim satelitor; - Rrjete fikse (pajisje terminal VSAT).

## **II. Transaksioni**

10. Më datë [...], shoqëria Vertex Holding SHPK (blerësi), CONCORD INVESTMENT SHPK (shitësi), kanë nënshkruar “Kontratë Shitje dhe Blerje Aksionesh”.
11. Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi ka rënë dakord të shesë tek blerësi të gjitha aksionet të cilat ai zotëron tek shoqëria target dhe blerësi ka rënë dakord të blejë këto aksione, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshje. Aksionet do të shiten nga shitësi dhe do të blihen nga blerësi duke transferuar njëkohësisht titullin dhe pronësinë mbi aksionet nga shitësi tek blerësi, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së aksioneve dhe kryerjes së pagesës siç parashikohet në këtë kontratë. Blerësi ka kryer procesin e “Due Diligence” dhe bie dakord të blejë aksionet e shoqërisë në gjendjen që shoqëria është, pa asnjë pretendim ndaj shitësit.
12. Si kushte paraprake, shitësi dhe blerësi kanë miratuar organet e tyre vendimmarrëse sipas statutit të tyre;(i) miratimin e shitjes/blerjes së aksioneve respektive nga shitësi tek blerësi dhe (ii) miratimin e nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes dhe transferimin e aksioneve. Gjithashtu blerësi do të ndjekë procedurat e njoftimit për ndryshimin e pronësisë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, etj.
13. Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, blerësi është njohur dhe ka pranuar:  
[...]
14. [...]
15. Palët bien dakord që brenda afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, aksionet do të jenë të lira nga çdo barrë.
16. Sipas nenit 3 “Përfundimi i Shitblerjes së Aksioneve”, palët nënshkruese kanë përcaktuar se: Marrëveshja hyn në fuqi dhe konsiderohet e përmbushur nga ana e blerësit në momentin që Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë miratimin për ndryshimin e pronësisë dhe vlera e çmimit të blerjes është e disponueshme/është kredituar në llogarinë bankare të shitësit pa kufizim.
17. Me kalimin e pronësisë së aksioneve nga shitësi tek blerësi, ky i fundit do të jetë aksionari i ri i vetëm i shoqërisë target dhe do të zotërojë 100.000 aksione të shoqërisë që përfaqësojnë 100%

të kapitalit aksionar të shoqërisë dhe shitësi nuk do të jetë më aksionar i shoqërisë target.

18. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

19. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
20. Veprimtaria e mediave audiovizive, që operojnë në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjor dalë për zbatim të tij. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe rregullimin e tregut mediatik në Shqipëri.
21. AMA lëshon Autorizim për kryerjen e shërbimit të programit audioviziv, kur shërbimi është:  
a) satelitor, kur mbështetet në një sistem satelitor; b) kabllor, kur mbështetet në një sistem kabllor; c) shërbimi on line, kur mbështetet në internet.
22. Transmetimet televizive në Shqipëri janë në një masë të madhe të liberalizuara. Ato realizohen në forma të ndryshme qoftë në transmetime të hapura analoge tokësore apo satelitore, qoftë numerike tokësore apo satelitore dhe kabllore. Operatorët televizivë që kryejnë transmetime të përmbajtjes televizive janë gjerësisht të përhapur, jo vetëm, por transmetime të përmbajtjes televizive kryhen dhe në internet apo ndërmjet IPTV, ku operatorët e shpërndarjes së internetit në Shqipëri janë të shumtë.
23. Shërbimi i transmetimit të kanaleve në platformën digjitale tokësore dhe satelitore ka hyrë si risi në vitin 2004 nga shoqëria Digitalb SHA.
24. Ndërkohë, shoqëria Tring TV SHA operon me 10 njësi shitjeje me markën Tring dhe bashkëpunon me mbi 130 pika partnere në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu ka një rrjet ndërkombëtar shpërndarjeje me partnerë të autorizuar në Mal të Zi, Kosovë, Greqi, Maqedoninë e Veriut, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Itali, Francë dhe Suedi.
25. Tring Tv SHA operon në tregun e televizionit me pagesë si (i) një operator distributor paketash me kanale (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit numerik dhe rrjetit satelitor, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit kabllor dhe IPTV-së. Pra, Tring transmeton përmbajtjet televizive me pagesë mbështetur në frekuenca

ashtu edhe mbështetur në rrjet komunikimi elektronik (kabëll ose IPTV). Tring Tv SHA ka në kanalet e saj operatorin kombëtar Vizion Plus.

26. Digitalb SHA është konkurenti i vetëm direkt i Tring Tv SHA në tregun e televizionit me pagesë. Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore dhe satelitore. Digitalb SHA është operatori kryesor që vepron në televizionin me pagesë në Shqipëri. Digitalb është njëkohësisht (i) një operator distributor paketash me kanale; (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale; si dhe (iv) transmetues nëpërmjet rrjetit të tij numerik me shtrirje kombëtare, si dhe nëpërmjet rrjetit satelitor. Në rolin e tij si transmetues, Digitalb SHA transmeton përmbajtjet televizive me pagesë nëpërmjet teknologjive që mbështeten në frekuenca, konkretisht: (i) Digitalb siguron mbulim kombëtar nëpërmjet rrjetit të tij tokësor numerik; si dhe (ii) siguron mbulim kombëtar dhe ndërkombëtar me transmetim satelitor.
27. Këto dy platforma, Digitalb dhe Tring, krijojnë kontent dhe operojnë në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor).
28. Referuar të ardhurave të realizuar në tregun e prodhimit transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video nga dy konkurrentet në treg, vihet re një ulje e tyre gjatë vitit 2024. Ndërmarrja Digitalb SHA zë një pjesë tregu prej XX% në bazë të xhiros së realizuar, ndërsa ndërmarrja Tring SHA zë XX% të tregut në bazë të xhiros së realizuar. Për vitin 2023 ndërmarrja Digitalb SHA zë një pjesë tregu prej XX% në bazë të xhiros së realizuar, ndërsa ndërmarrja Tring SHA zë XX% të tregut në bazë të xhiros së realizuar.
29. Ndërkohë, në tregun e televizionit me pagesë veprojnë edhe operatorët kabllorë, të licencuar si ripërsëritës programi, të cilët transmetojnë vetëm nëpërmjet teknologjive që nuk mbështeten në frekuenca (kabëll, rrjet komunikimesh elektronike, IPTV, etj). Operatorët kabllorë nuk prodhojnë, editojnë, apo janë distributorë të mirëfilltë, këta operatorë janë thjesht shpërndarës të programeve të të tretëve dhe në këto kushte mbeten shpërndarës të programeve të ofuara nga Digitalb dhe Tring, duke përdorur rrjetin e tyre kabllor. Sipas të dhënave të administruara nga AMA për vitin 2024 janë 66 operatorë kabllorë të licencuar.
30. Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK përbën një përqendrim konglomerat, pasi palët ushtrojnë aktivitetin në tregje të ndryshme.
31. Shoqëria blerëse nuk ka aktivitet (shoqëri holding) dhe nuk ka eksperiencë të mëhershme në tregun e media audiovizive.
32. Nisur nga struktura e tregut përkatës, mungesa e një informacioni të plotë për të vlerësuar mundësinë reale të blerësit për të ushtruar aftësitë funksionale dhe për të siguruar

vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target, me qëllim vlerësimin e efekteve të transaksionit mbi konkurrencën në treg, kërkohet një analizë më të thelluar e ndikimit dhe pasojave në tregun përkatës të produktit.

33. Sipas parashikimeve të nenit 56 “Procedura paraprake” të Ligjit 9121/2003, në rastet kur ka dyshime se potencialisht përqendrimi mund të shfaqë shenja anti konkurrese, vendoset fillimi i procedurës së thelluar.
34. Procedura e thelluar në rastet e kontrollit të përqendrimeve, sipas parashikimeve të nenit 57 të ligjit, ka të bëjë më kryerjen e analizave më të thelluara ekonomike dhe të efekteve që ky përqendrim sjell në treg. Gjatë kësaj procedure dhe kur ka dyshime apo shfaqen shqetësimi se ky transaksion mund të kufizojë konkurrencën në treg, kërkohet një informacion më i detajuar, përfshirë edhe dokumente të brendshme të vetë ndërmarrjes apo edhe pyetësorë<sup>1</sup>.
35. Gjithashtu gjatë kësaj faze, analizohen eficientat e pritshme të pretenduara nga ndërmarrja si pasojë e këtij përqendrimi dhe nëse ka efekte pozitive të këtyre eficientave tek konsumatorët, të cilat tejkalojnë ato efekte që mendohen se shkelin parimet e konkurrencës, atëherë përqendrimi autorizohet.
36. Këto eficienta duhet të përmbushin kushtet dhe barra e provës bie mbi ndërmarrjet palë në transaksion për të provuar se këto eficienta janë plotësuar. Sipas parashikimeve të pikës VII “Eficientat” të Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, së pari këto eficienta duhet të jenë të verifikueshme, specifike lidhur me këtë përqendrim dhe eficientat duhet të sjellin përfitime për konsumatorët.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d; nenit 56 pika 1, germa b) dhe nenit 57 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.
2. Raporti i procedurës së thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së këtij vendimit.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

<sup>1</sup> Nëse konsiderohet e nevojshme mundet të kryhen edhe inspektive pranë ndërmarrjes.

**VENDIM**

**Nr. 1227, Datë 18.11.2025**

**“PËR VLERËSIMIN LIGJOR MBI “MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT  
“NDËRMJET PALËVE TË TREGUT TË SIGURIMEVE MBI SHKËMBIMIN E  
INFORMACIONIT PËR TREGUN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PRONARIT  
TË MJETIT MOTORIK PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË TRETA””**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar
Znj. Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025,shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për vlerësimin ligjor mbi “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta””.

**Baza Ligjore:** Neni 4, neni 6, neni 24 germa (d) dhe neni 26 i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

**VËREN SE :**

1. Në mbështetje të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 295, datë 14.11.2013, Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 4146 prot., datë 17.10.2025 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës më nr. 918 prot., datë 17.10.2025), ka depozituar “Marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.
2. Afati i marrëveshjes së bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorik

për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, sipas Vendimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 751, datë 26.11.2020, përfundon në 26 nëntor 2025.

3. Duke marrë parasysh funksionimin pozitiv që ka treguar zbatimit i marrëveshjes së bashkëpunimit dhe duke pasur parasysh implementimin nga ana e Byrosë Shqiptare të Sigurimit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 751, datë 26.11.2020, është vlerësuar e nevojshme nga BSHS miratimi i Marrëveshjes së re të Bashkëpunimit midis shoqërive të sigurimit.
4. Palët pjesëmarrëse shprehen se, për zbatimin e kësaj marrëveshje do të përcaktojnë modalitetet për mënyrën e administrimit, por edhe të kontrollit pa tejkalluar parashikimet e kësaj marrëveshjeje, duke siguruar që në asnjë rast zbatimi i marrëveshjes të jetë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve dhe parimeve të konkurrencës së lirë në treg, marrëveshja të mos kufizojë produktin apo shitjet, të mos ndajë tregun, përcaktojë, apo ndajë primet. Pra në terma konkretë, kjo marrëveshje, sanksionon vetëm bashkëpunimin midis palëve të sigurimit nënshkruese të saj, për mënyrën e shkëmbimit të informacionit por në asnjë mënyrë, përcaktimin e çmimeve apo ndarjen e tregut midis ndërmarrjeve nënshkruese.
5. Objekti i kësaj marrëveshjeje i referohet (i) metodologjisë së përllogaritjes të tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve, (ii) vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta, (iii) mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh, (iv) shlyerja e dëmeve, (v) Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë dhe (vi) regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda.
6. Qëllimi i marrëveshjes do të jetë shkëmbimi i informacioneve mes palëve në marrëveshje për mbulimin e risqeve të policave të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta MTPL e brendshme për vendosjen e standarteve në drejtim të sigurimit të mosfalsifikimit të policave të sigurimit MTPL e brendshme, shqyrtimin e informacionit i cili mund të përfshijë disa llogaritje statistikore duke lejuar llogaritjen e kostos mesatare të mbulimit të një rreziku specifik në të shkuaren ose për siguracionin e jetës, tabelat e normave të vdekshmërisë apo të frekuencës së sëmundjeve, aksidentet dhe invaliditeti, ose të tjera të lidhura me MTPL, të cilat bejnë të mundur përmiresimin e njohurive mbi rreziqet dhe lehtëson vlerësimin e rreziqeve për kompanitë individuale, duke mos penguar në asnjë rast konkurrencën mes palëve. Për të rritur transparencën dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale dhe respektimin e primit të depozituar në AMF, nga të gjitha palët, shoqëritë e sigurimit nënshkruese të kësaj marrëveshje pranojnë që për çdo police sigurimi të leshuar të evidentohen qartë elementet identifikues të secilit operator, logo, nr. serial, nënshkrimin e operatorit dhe kodin e AMF-së, si dhe arkëtimin në kohe reale të primit të sigurimit. Këto specifikime në rast zbatimi korrekt në praktikë, bëjnë të mundur mosfalsifikimin e primeve të

miratuara nga AMF, duke mos cënuar në këtë mënyrë për asnjë moment konkurrencën e lirë në treg si dhe duke i dhënë mundësi klientëve të zgjedhin lirisht dhe në çdo moment të sigurohen në atë shoqëri sigurimi që dëshirojnë duke mos favorizuar në asnjë moment asnjë nga palët e kësaj marrëveshjeje.

7. Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se nuk do të shkelin asnjë nga parashikimet e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve të tjera nënligjore.
8. Në zbatim të Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet shoqërive të sigurimit mbi shkëmbimin e informacionit në tregun e sigurimit të detyrueshëm MTPL përbën një marrëveshje horizontale, pasi palët në marrëveshje janë ndërmarrje konkurrense që ofrojnë të njëjtin produkt sigurimi.
9. Nga analiza e objektit të marrëveshjes rezulton se marrëveshja synon shkëmbimin e informacionit vetëm për qëllime statistikore dhe historike mbi tregun MTPL, që lidhet me analizën e riskut, llogaritjet e kostos mesatare të mbulimit të një rreziku të kaluar, të dhënat mbi aksidentet, vdekshmërinë dhe invaliditetin, si dhe çdo informacion tjetër statistikore i ngjashëm që lidhet me natyrën e produktit MTPL. Marrëveshja nuk përmban dispozita që krijojnë detyrime apo koordinim në përcaktimin e çmimeve/primeve, kushteve të shitjes apo ndarjes së klientëve dhe parashikon ndalimin e shkëmbimit të të dhënave të ndjeshme konkurruese. Për rrjedhojë, marrëveshja nuk paraqet kufizim të konkurrencës sipas objektit.
10. Vlerësuar në këndvështrimin e efekteve potenciale mbi tregun, shkëmbimi i informacionit në formën e përshkruar nuk bën të mundur koordinimin e sjelljes së palëve në treg ose unifikimin e primeve. Ky shkëmbim synon përmirësimin e njohurive dhe vlerësimin e riskut nga secila shoqëri sigurimi, pa krijuar një koordinim të sjelljes dhe pa kufizuar konkurrencën në treg. Për këtë arsye, marrëveshja nuk gjeneron efekte të prishme kufizuese mbi konkurrencën.
11. Për sa më sipër vlerësohet se marrëveshja është në përputhje me Ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 295 , datë 14.11.2013.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 6, nenin 24 germa (d) dhe nenin 26, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Marrëveshja e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mejtit motorrik për

përgjegjësine ndaj palëve të treta”, për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe me Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”, miratuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 295, datë 14.11.2013.

- II. Në marrëveshjen e bashkëpunimit “Ndërmjet palëve të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të pronarit të mjetit motorrik për përgjegjësine ndaj palëve të treta”, të shtohen kushtet dhe detyrimet si më poshtë vijon:
- i. marrëveshja mos të kufizojë produktin MTPL apo shitjet;
  - ii. marrëveshja mos të ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL dhe;
  - iii. ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi në asnjë rast nuk duhet të dakordësohen për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.
- III. Në pikën II.2 “Qëllimi i marrëveshjes” të ndryshohet dhe të shtohet:
- i. Qëllimi i marrëveshjes është rritja e efikasitetit në trajtimin e dëmeve dhe uljen e numrit të mjeteve të pasiguruara;
  - ii. Shkëmbimi i informacionit do të kufizohet vetëm në të dhënat statistikore dhe të përmbledhura, për të përmirësuar njohuritë mbi rreziqet dhe vlerësimin e riskut nga secila ndërmarrje, pa penguar dhe kufizuar konkurrencën në treg si dhe vendimmarrjen e pavarur të palëve;
  - iii. Periudha kohore për të cilën do të shkëmbehet informacioni me qëllim realizimin e llogaritjeve të përbashkëta, tabelave dhe studimeve të përbashkëta.
- IV. Në pikën II.3 “Detyrimet e palëve” të ndryshohet dhe të shtohet:
- i. Palët kanë detyrimin që të mos japin asnjë informacion mbi çmimet, primet, kostot, fitimet apo çdo element tjetër që mund të ndikojë në përcaktimin e çmimit fundor të policës MTPL;
  - ii. Palët duhet të raportojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për masat e ndërmarra për sigurimin e mosfalsifikimit të policave MTPL të brendshme;
  - iii. Palët vendosin në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës informacionin e shkëmbyer sipas marrëveshjes sa herë që kërkohet.
  - iv. Të hiqet pika 8 ku thuhet: “Tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm për mjetet e transportit për përgjegjësité ndaj palëve të treta vetëm në pikat e autorizuara të seilës prej kompanive”.
- V. Në pikën II.6 “Kontrolli i zbatimit të marrëveshjes” të shtohet:
- i. Në rast përjashtimi të palëve nga marrëveshja, duhet të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës për këtë fakt;

- ii. Byroja Shqiptare e Sigurimeve do të monitorojë zbatimin e marrëveshjes sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitat e këtij vendimi, duke siguruar që marrëveshja të mos kufizojë produktin MTPL apo shitjet, të mos ndajë tregun apo klientët që blejnë produktin MTPL dhe ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë marrëveshje bashkëpunimi duhet të mos kenë rënë dakord për primet e shitjes, të zbatuara për produktin MTPL.

VI. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 3 (tre) vjeçare.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1228, Datë 18.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË SPACE+ SHA NGA SHOQËRIA GLG INVESTMENT SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmartjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje Kuadër për Riorganizimin e shoqërisë Space+ SHA”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi/aksionari hyrës: GLG INVESTMENT SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti; kryerja e të gjitha

aktiviteteve tregtare në përputhje me dispozitat ligjore shqiptare në fuqi, më specifiku: themelimi dhe krijimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja si dhe pjesëmarrja në to, administrimi dhe drejtimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjeve vendase apo të huaja; blerja apo disponimi mbi pjesëmarrjen të kapitalit në korporata, partneritete apo shoqëri dhe sindikata me objekte aktiviteti të ndryshme, blerja dhe shitja e aksioneve dhe kuotave apo pjesëmarrje të tjera në sipërmarrje dhe shoqëri, brenda kufijve të lejuar nga legjislacioni i aplikueshëm; blerja, barrësimi, hipotekimi dhe transferimi i pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme si dhe titujve; pjesëmarrje në shoqëri me objekte aktiviteti në fushën e ndërtimit, investime në energjetike, imobiliare, në lojra fati etj; Gjithashtu në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryejë dhe të realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt apo indirekt, është si rrjedhim apo ka të bëjë me objektivat e renditura më sipër. Për të arritur qëllimin e mësipërm shoqëria mund të ndërmarrë veprime me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, për dhënie me qira apo hipotekim që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objektivi i shoqërisë. Shoqëria GLG INVESTMENT SHPK zotërohet me XX % të kapitalit nga shoqëria Lake Horizont LLC.

4. Shoqëria GLG INVESTMENT SHPK është një shoqëri e krijuar rishtazi, për të funksionuar si shoqëri holding, dhe si e tillë nuk ka vlera dhe volume shitjesh.
5. **Shitësi: ALB – STAR SHPK/aksionari dalës** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: Ndërtime civile, industriale, tregti import export. Transport i mallrave për të tretë me qira dhe për llogari të vet brenda vendit. Tregti me shumicë e ujit të pijshëm dhe e ujit industrial. Transport me mjete jashtë norme për llogari të vet dhe të tretë brenda dhe jashtë vendit. Menaxhim i mbetjeve jo të rrezikshme (aktivitet grumbullim dhe transport i mbetjeve jo të rrezikshme). Hapja dhe menaxhimi i hoteleve "Strukturë Akomoduese 4 ose 5 yje", e godinave dhe ambienteve në të cilat ushtrohet aktivitet hotelier. Hapja dhe menaxhimi i sallave të konferencave në kuadër të aktivitetit hotelier. Hapja, menaxhimi dhe funksionimi i qendrave të rekreacionit, fitness dhe pishina. Aktivitet në fushën e qiradhënies të zyrave, ambienteve tregtare dhe/ose pasurive të tjera të paluajtshme që i përkasin hotelit. Kryerja e tregtimit, prodhimit dhe përpunimit të mallrave, që kanë të bëjnë me aktivitetin e hotelerisë. Hapja e menaxhimi i bareve dhe restoranteve brenda strukturës hoteliere si dhe ushtrimi i aktivitetit në fushën e këmbimit valutor dhe të mallrave të çmuar, bizhuteri, apo sende me vlerë të kuotuar në bursë dhe çdo gjë tjetër që përfshijnë fushat e mësipërme, të lejuara nga ligji.
6. Shoqëria ALB – STAR SHPK zotërohet XX % nga shoqëria FINMAN SHPK.
7. **Shoqëria Target: Space+ SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kategorinë kazino në hotel me 5 yje, duke përfshirë çdo veprimtari të lidhur e të nevojshme, përfshirë por pa u kufizuar në financimin, licencimin dhe operimin e kazinosë, në përputhje me legjislacionin shqiptar të zbatueshëm, duke përfshirë specifiku sa vijon: Organizimi dhe kryerja e

aktivitetit që lidhet me kazinotë dhe me lojërat e fatit. Shërbime këmbimi valutë brenda ambienteve të kazinosë në përputhje me dispozitat ligjore rregullatore të detyrueshme në fuqi. Trajnimi i stafit të ri apo ekzistues të kazinosë për qëllime të aktivitetit të kazinosë me synimin e punësimit të një stafi të kualifikuar. Import-eksport të pajisjeve dhe të materialeve lidhur me kazinotë dhe me lojërat e fatit. Investim në fushën e real estate, pasurive të paluajshme. Organizim eventesh, koncertesh dhe turne të ndryshëm. Bar, restorant, shërbime turistike dhe mikpritëse. Krijimi dhe operimi i bareve dhe restoranteve, import eksport ushqimesh, pijesh dhe lëndë të parë. Në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së kazinosë, organizim eventesh, koncertesh, muzike live, turne të ndryshëm, shërbime turistike dhe mikpritëse. Shoqëria mund të kryejë veprimtari të tjera të lidhura apo në funksion të objektit të mësipërm. • Shoqëria mund të kryejë dhe çdo aktivitet tjetër që është i nevojshëm për realizimin e objektit të saj dhe funksionimin e duhur të Shoqërisë.

8. Shoqëria target aktualisht kontrollohet nga shoqëria ALB – STAR SHPK me XX% të kapitalit aksionar dhe nga shoqëria Wss-CZ Holdings s.r.o. me XX% të të kapitalit aksionar.

## II. Transaksioni

9. Më datë [...], shoqëria GLG INVESTMENT SHPK (blerësi/aksionari hyrës), ALB – STAR SHPK (shitësi/aksionari dalës), kanë nënshkruar “Marrëveshje Kuadër për Riorganizimin e shoqërisë Space + SHA”. Qëllimi i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i kushteve dhe hapave për realizimin e largimit të Aksionarit dalës nga Space+ SHA dhe hyrjes së Aksionarit hyrës si aksionar i ri kontrollues i Space+ SHA.
10. Palët bien dakord se procesi i riorganizimit të Space+ SHA, do të bëhet menjëherë pas realizimit të hapave paraprake dhe marrjes së miratimeve të: Aksionarit hyrës nga AMLF dhe miratimin e përqendrimit nga Autoriteti i Konkurrencës. Menjëherë dhe jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditësh pune pas plotësimit të kushteve paraprake, palët do të marrin përsipër të nënshkruajnë Vendimin e Asamblesë së Space+ SHA, lidhur me miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë target, nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja që do të nënshkruhen nga Aksionari hyrës, sipas shtojcave bashkëlidhur kësaj Marrëveshje.
11. Në lidhje me këtë transaksion, Autoriteti Mbikëqyrës i Lojërave të Fatit ka dhënë miratimin paraprak për ndryshime në strukturën aksionare dhe kapitalin e shoqërisë Space+ SHA.
12. Referuar Marrëveshjes Kuadër për Riorganizimin e shoqërisë Space+ SHA, të nënshkruar më datë [...], është dakordësuar se struktura e kontrollit të shoqërisë Space+ SHA, do të ndryshojë nëpërmjet largimit të aksionarit ekzistues ALB – STAR SHPK, i cili zotëron 99% të kapitalit aksionar të shoqërisë target dhe hyrjes si aksionar të shoqërisë GLG INVESTMENT SHPK.
13. Në përmbyllje të këtij transaksioni shoqëria GLG INVESTMENT SHPK do të zotërojë 99% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, si aksionar i ri kontrollues dhe 1% e kapitalit aksionar

do të zotërohet nga ortakut W-CZ Holdings s.r.o..

14. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimit të aktiviteteve të lojërave të fatit në kategorinë kazino në hotel me 5 yje dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Tregu i lojërave të fatit rregullohet me ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” i përditësuar. Ky ligj përcakton kategoritë e lojërave të fatit të lejuara, kushtet, kriteret dhe procedurat që rregullojnë këtë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, si dhe detyrat, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit.
17. Në tregun e lojërave të fatit, Kazino të vendosura në hotele me 5 yje, [...].
18. [...].
19. Transaksioni i propozuar do të ketë për pasojë përfitim të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK.
20. Shoqëria GLG INVESTMENT SHPK është një shoqëri e krijuar rishtazi për të funksionuar si shoqëri holding dhe si e tillë nuk ka vlera dhe volume shitjesh.
21. Shoqëria target, Space+ SHA ushtron veprimtari në fushën e lojërave të fatit, [...].
22. Transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat, pasi pala blerëse dhe shoqëria target operojnë në tregje të ndryshme. Për më tepër pala blerëse është një shoqëri holding dhe përfitimi i kontrollit mbi shoqërinë SPACE + nuk do të ketë për pasojë ndryshimin në strukturat e tregut.
23. Transaksioni i propozuar do të realizohet nëpërmjet futjes së një aseti, tokë, në kapitalin e shoqërisë target dhe sipas deklaratë së palës njoftuese, transaksioni ka për qëllim rritjen e biznesit dhe zgjerimin e fushës së investimeve të shoqërisë GLG INVESTMENT SHPK në tregun shqiptar.
24. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk pritet të sjellë ndryshime në strukturat e tregut.

25. Nga sa më sipër, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Space+ SHA nga shoqëria GLG INVESTMENT SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1229, Datë 18.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË QUMESHTI AJKA SHA NGA SHOQËRIA SAIMBEI SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK.
2. Referuar dokumentit “Kontratë për shit-blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: SAIMBEI SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndërtimin e

ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujësjellësve, ujërave mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin dhe rehabilitimin e veprave ujitëse, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe çdo ndërtim tjetër, etj. Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm, z. Flamur Behi.

4. **Shitësi: T.T.A ALBA LAM SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shërbime të ndryshme si bar - restorante, hoteleri, lavanderi, shërbim taksi, transport klientësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit, aktivitete turistike, katering, dhënie ambientesh me qira. Shërbim evente, seminare dhe pritje zyrtare. Import dhe eksport të mallrave, tregtimi i të gjitha llojeve të mallrave, etj, shërbime pastrimi gropash septike dhe kanalizimesh me makineri, shërbim me WC kimike, pastrim sipërfaqesh urbane dhe gjelbërim i tyre, transport ndërkombëtar mallrash, kryerja e investimeve në të gjitha fushat kryesisht për bar- restorant, hoteleri, punime të përgjithshme ndërtimi civile dhe industriale, rikonstruksione objektesh, punime në sheshe publike, rruge, trotuare punime për prishje, prodhim strukturash parafabrikate për të gjitha funksionet (fjetina, zyra, kampe, menca, vendroje) si dhe punime konstruksione metalike ku përfshihen të gjitha llojet e punimeve, punime alumini dhe xhami, druri, etj. Shoqëria zotërohet nga ortaku i vetëm, z. Ilir Mata.
5. **Target: QUMESHTI AJKA SHA** është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar më datë 09.11.1195, me objekt aktiviteti: grumbullim dhe përpunim qumështi dhe i nënprodukteve të tij, import eksport lëndësh të para ndihmëse dhe produkteve të gatshme, tregtim i produkteve ushqimore, shërbime tranziti dhe magazinash.
6. Referuar Estraktit Historik të shoqërisë target rezulton se shoqëria zotërohet në XX% të aksioneve nga shoqëria T.T.A ALBA LAM SHPK dhe pjesa tjetër nga XX ortakë minorance, me një përqindje me më pak se XX% të aksioneve.
7. Në momentin e regjistrimit, shoqëria përfaqësonte një shoqëri aksionere me kapital shtetëror, e zotëruar nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit. Në vitin 2000, shoqëria privatizohet dhe XX% e aksioneve i shitet shoqërisë Aldosch SHPK.
8. Në vitin 2009, shoqëria T.T.A ALBA LAM SHPK blen kuotat e shoqërisë Aldosch SHPK, si dhe pjesën takuese të XX ortakëve në minorance, duke zotëruar XX% të aksioneve të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA. Pas disa transaksioneve në vitin 2012 (blerje të aksioneve në minorance), shoqëria T.T.A ALBA LAM SHPK zotëron sot XX% të aksioneve të shoqërisë.

## II. Transaksioni

9. Më datë [...], Ortaku i vetëm i shoqërisë T.T.A ALBA LAM SHPK, me vendimin nr. 111 të Asamblesë së Përgjithshme, vendosi miratimin e operacionit të shitjes së Aksioneve prej 98.185% që zotëron tek shoqëria QUMESHTI AJKA SHA.
10. Më datë [...], Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA, vendosi miratimin e realizimit të transaksionit të transferimit të aksioneve dhe vendimit të shoqërisë T.T.A ALBA LAM SHPK (shitësi) për shitjen e aksioneve.
11. Më datë [...], Ortaku i vetëm i shoqërisë SAIMBEI SHPK, me vendimin nr. 8 të Asamblesë së Ortakëve vendosi, miratimin e operacionit të blerjes së Aksioneve prej 98.185% që shoqëria T.T.A ALBA LAM SHPK zotëron tek shoqëria QUMESHTI AJKA SHA.
12. Më datë [...], është nënshkruar dokumenti “Kontratë për shit-blerjen e aksioneve”, mes palëve, shoqërisë T.T.A ALBA LAM SHPK (shitësi) dhe SAIMBEI SHPK (blerësi).
13. Palët kanë rënë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes së aksioneve të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA dhe objekt i kontratës është transferimi nga Shitësi tek Blerës, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara të kontratë, të XX% të Aksioneve dhe çdo të drejte që u përket aksioneve, të lira nga çdo Barrë, për një vlerë të rënë dakord mes palëve.<sup>2</sup>
14. Në përfundim të transaksionit, shoqëria target do të zotërohet në masën XX % të Aksioneve nga shoqëria SAIMBEI SHPK dhe pjesa e mbetur nga aksionarë pakice.
15. Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

16. Nga vlerësimi i dokumentacionit të dosjes u konstatua se shoqëria QUMESHTI AJKA SHA, që nga data 12.04.2019, ka pezulluar aktivitetin ekonomik dhe prej kësaj periudhe nuk ka realizuar të ardhura.
17. Në Formularin e njoftimit të përqendrimit, pala njoftuese deklaroi se, qëllimi i transaksionit të përfitim të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK është zotërimi i aseteve (tokë truall) të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA, dhe bashkëlidhur dosjes, pala njoftuese ka depozituar [...].
18. Nga një kërkim në informacionet e publikuara si dhe referuar Deklaratës Noteriale, konstatohet se shoqëria QUMESHTI AJKA SHA; [...].

---

<sup>2</sup> Konstatohet një mospërputhje mes përqindjes së aksioneve objekt shitje dhe përqindjes së aksioneve që rezultojnë në pronësi të shitësit në QKB. Gjithsesi kjo pasaktësi nuk ndikon në fuqinë kontrolluese të shoqërisë T.T.A ALBA LAM SHPK mbi shoqërinë target.

19. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe arsyes ekonomike të transaksionit, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ndërtimit të rezidencave të banimit dhe shërbimit dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i qytetit të Tiranës.
20. Shoqëria QUMESHTI AJKA SHA ka ushtruar aktivitetin e grumbullit dhe përpunimit të qumështit dhe i nënprodukteve të tij, import eksport lëndësh të para ndihmëse dhe produkteve të gatshme, tregtimi i produkteve ushqimore, por nuk është aktive ne tregun objekt aktiviteti.
21. Shoqëria SAIMBEI SHPK aktualisht operon në tregun e import- eksport, tregti cigaresh dhe artikuj të ndryshëm, si dhe është e pajisur me Licence Profesionale të punimeve të zbatimit në ndërtim.
22. Shoqëria SAIMBEI SHPK, [...] janë pjesëmarrës në dy projekteve ndërtimore ne rrugën 5 Maji, Tirane. Zona ndërtimore, është vlerësuar si një territor me kapacitete zhvillimi dhe përfundimi i tyre pritet të sjell një rritje të ofertës në treg për apartamente dhe njësi shërbimi.
23. Sipas të dhënave të INSTAT, që prej vitit 2023, sektori i ndërtimit ka paraqitur treguesit më të lartë të lejeve te ndërtimit në 10 vitet e fundit, ku në tremujorin e 2 të vitit 2025, numri i leje për rezidenca banimi në nivel vendi ka qene 271 lejë, ndërkohë që për ndërtesa të tjera jorezidenciale ( hotele, zyra, ndërtesa industriale dhe tregtare ) ka qene 81 lejë.
24. Transaksioni i propozuar i përfutimit të kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe nuk pritet të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të palëve pjesëmarrëse ne transaksion.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfutimin e kontrollit të shoqërisë QUMESHTI AJKA SHA nga shoqëria SAIMBEI SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1230, Datë 18.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË MERCATOR-EMBA, PROIZVODNJA HRANE, D.O.O. NGA SHOQËRIA AGRANA INTERNATIONALE VERWALTUNGS-UND ASSET-MANAGEMENT GMBH”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesi i hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesi i hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesi i hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje aksionesh”, të nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit austriak, me objekt aktiviteti: menaxhim i aksioneve dhe investimeve. Aksionar kryesor i blerësit është shoqëria AGRANA Beteiligungs-Aktiengesellschaft (AG), (AGRANA) me kapital aksionar prej XX%.
4. Shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH është pjesë e Grupit Agrana. Grupi AGRANA është një përpunues i lëndëve të para bujqësore, të cilat janë të strukturuar në tre divizione operative: sheqer, niseshte dhe fruta.
5. Grupi AGRANA është prezent në Shqipëri përmes filialit të saj AGRANA-STUDEN Albania SHPK. AGRANA - STUDEN Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt veprimtarie: tregtimi me shumicë i sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore, si dhe veprimtari të tjera që kanë lidhje me tregtimin me shumicë/pakicë, distribucionin, logjistikën, etj. Ajo operon si një shoqëri shpërndarjeje për tregun shqiptar dhe është pjesë e një rrjeti shumë më të gjerë të shoqërive të shpërndarjes AGRANA – STUDEN dhe AGRAGOLD në Evropën Juglindore.
6. **Shitësi: Poslovni sistem Mercator d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, e regjistruar në Ljubljana.
7. **Target: Mercator – Emba, proizvodnja hrane, d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, një nga prodhuesit kryesorë të mbushjeve për ëmbëlsira dhe produkteve të kakaos së menjëhershme në Evropën Juglindore.
8. Shoqëria Mercator – Emba prodhon një gamë të gjerë produktesh të përshtatshme për industrinë e qumështit dhe akullores; përgatitje të tipit kakao / çokollatë; produkte të tipit karamel; përgatitje frutash me copa frutash, manaferra të plota ose pure; aroma të tjera si vanilje, arra, vezë etj. Shoqëria target aktualisht kontrollohet nga shoqëria Poslovni sistemi Mercator d.o.o. Mercator-Emba.
9. Mercator – Emba nuk është prezent dhe nuk ka realizuar të ardhura në Shqipëri për vitin 2024.

## II. Përqendrimi

10. Më datë [...] shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH (Blerësi) dhe shoqëria Poslovni sistem Mercator d.o.o. (Shitësi) kanë nënshkruar “Marrëveshje për blerje aksionesh”, lidhur me shitjen dhe blerjen e shoqërisë Mercator-Emba, proizvodnja hrane, d.o.o..
11. Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje, shitësi shet dhe në mbyllje transferon Aksionin, [...].
12. Referuar deklaramit të palës njoftuese, [...].

13. Pas përfundimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target do të kontrollohet indirekt nga AGRANA Beteiligungs-Aktiengesellschaft.
14. Për sa më sipër transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesi i hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të mbushjeve për ëmbëlsira dhe produkteve të kakaos së menjëhershme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesi i hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH. Transaksioni i synuar konsiderohet si një përqendrim konglomerat pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.
17. Shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH është një shoqëri me objekt aktiviteti menaxhim i aksioneve dhe investimeve dhe është pjesë e Grupit AGRANA. Grupi AGRANA është një përpunues i lëndëve të para bujqësore, të cilat janë të strukturuar në tre divizione operative: sheqer, niseshte dhe fruta.
18. Grupi AGRANA ka një degë në Shqipëri, shoqërinë AGRANA-STUDEN Albania SHPK, e cila ka për objekt aktiviteti tregtimin me shumicë të sheqerit dhe prodhimeve të tjera ushqimore.
19. Shoqëria Mercator – Emba është një nga prodhuesit kryesorë të mbushjeve për ëmbëlsira dhe produkteve të kakaos së menjëhershme. Shoqëria prodhon një gamë të gjerë produktesh të përshtatshme për industrinë e qumështit dhe akullores, produkte të tipit kakao/çokolletë/karamel, si dhe produkte me bazë frutash.
20. Mercator – Emba nuk është prezent dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri për vitin 2024.
21. Në përfundim të analizës, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis

aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk pritet të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Mercator-Emba, prodhuesja e hrane, d.o.o. nga shoqëria AGRANA Internationale Verwaltungs-und Asset-Management GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1231, Datë 18.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË NIDDA GERMAN TOPCO GMBH NGA SHOQËRIA SAXOPHONE GERMANY BIDCO GMBH”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH.
2. Referuar dokumentit “Kontratë Shitblerje”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Saxophone Germany BidCo GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt veprimtarie menaxhimi i aseteve të veta, si dhe blerja, shitja, mbajtja dhe menaxhimi i investimeve në shoqëri të tjera aktive në tregun e

kujdesit shëndetësor, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Blerësi është një mjet investimi për qëllime të veçanta, i krijuar vetëm për qëllime të këtij transaksioni. Për qëllime të këtij transaksioni dhe para Mbylljes së tij, blerësi direkt do të jetë në pronësi indirekt të Saxophone Jersey Topco Ltd.

4. Saxophone Germany BidCo GmbH kontrollohet indirekt nga CapVest Partners LLP (CapVest), një firmë kapitali privat e tregut të mesëm e fokusuar në industri shumë elastike, ku nxitësi i kërkesës për produktin ose shërbimin nuk është diskrecionar. Sektorët kryesorë të CapVest janë produktet bazë të konsumit, kujdesi shëndetësor dhe shërbimet thelbësore. CapVest mban investime kryesisht përmes dy fondeve të kapitalit privat në biznese në të gjithë Evropën dhe Amerikën e Veriut. CapVest nuk kontrollohet nga asnjë entitet ose individ.
5. [.....]
6. **Shitësi: Nidda MidCo S.á.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Luksemburgut.
7. Nidda MidCo S.á.r.l. është në pronësi dhe kontrollohet në mënyrë të përbashkët nga fondet e administruara dhe / ose të këshilluara nga Bain Capital Investors, LLC (Bain Capital) dhe Fondi i Gjashtë Civen (Cinven VI) (së bashku Investitorët Shitës).
8. **Shoqëria Target: Nidda German Topco GmbH** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt veprimtarie menaxhimi i asetëve të veta, si dhe blerja, shitja, mbajtja dhe menaxhimi i investimeve në shoqëri të tjera aktive në tregun e kujdesit shëndetësor, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.
9. Nidda German Topco GmbH zotëron në mënyrë indirekte 100% të kapitalit aksionar të emetuar të STADA Arzneimittel AG dhe kjo e fundit është shoqëria kryesore operative e Grupit STADA. Grupi STADA është aktiv në industrinë farmaceutike me prani lokale në të gjitha tregjet kryesore evropiane, e më tej dhe ofron një portofol të larmishëm produktesh për një gamë fushash terapeutike, duke u përqendruar në tre segmente biznesi:
  - i. Kujdesi shëndetësor për konsumatorët (barna pa recetë me status rregullator si barna ose pajisje mjekësore pa recetë “OTC”, kozmeceutikë dhe kozmetikë, vitamina, minerale dhe suplemente);
  - ii. Barna gjenerike (barna me recetë të shitura nën një emër ndërkombëtar jo-pronësor);
  - iii. Barna specialë (barna gjenerikë të markës, barna gjenerike speciale, biosimilarë dhe trajtime inovative dhe të rralla për sëmundje).
10. Grupi STADA është gjithashtu aktiv, në një masë të kufizuar, në ofrimin e shërbimeve të prodhimit me kontratë ( Shërbimet CMO), kryesisht për produktet e përfunduara farmaceutike (FDP) për klientë në vende të caktuara (jo në Shqipëri).
11. [.....]

## II. Përqendrimi

12. Ndërmjet shoqërisë Saxophone Germany BidCo GmbH (blerësi) dhe shoqërisë Nidda Midco S.á.r.l. (shitësi) është lidhur “Kontratë Shitblerje”.
13. [.....]
14. [.....]
15. [.....]
16. [.....]
17. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

## III. Analiza e konkurrencës

18. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve farmaceutike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
19. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH.
20. Blerësi, shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH, është një shoqëri holding, e themeluar për qëllimet e realizimit të transaksionit duke mos patur asnjë aktivitet operativ të vetin dhe duke mos gjeneruar as xhiro. Kjo shoqëri kontrollon indirekt nga CapVest Partners LLP. Asnjë prej shoqërive të portofolit të CapVest nuk është prezente në tregun përkatës në Shqipëri.
21. Shoqëria target, Nidda German Topco GmbH është një shoqëri holding e Grupit STADA. Grupi STADA është aktiv në industrinë farmaceutike me prani lokale në të gjitha tregjet kryesore evropiane, si dhe në tregjet në rritje në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, Azi dhe Australi.
22. [.....]
23. Nga analiza, u konstatua se përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk pritet të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë Nidda German Topco GmbH nga shoqëria Saxophone Germany BidCo GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1232, Datë 26.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË DIAL-ALB SHPK NGA SHOQËRIA EVITA SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni i përfimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK.
2. Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e kuotës”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Evita SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila operon në tregun e import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumenteve dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa

ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtim me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve dhe aksesorëve të tyre etj.

4. Shoqëria Evita SHPK zotërohet nga Ortaku z.Ertel Kërçuku në masën XX% të kapitalit dhe nga shoqëria Arimo B.V në masën XX%.
5. Shoqëria Evita zotëron kuota dhe ka kontroll të përbashkët në shoqëritë PHARMA ONE SHPK (XX % të kapitalit); [...].
6. **Pala shitëse: Znj. Alba Rista**, shtetase shqiptare, e cila para transaksionit zotëronte XX% të kapitalit themeltar të shoqërisë target DIAL-ALB SHPK.
7. **Shoqëria Target: DIAL-ALB SHPK**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila ka objekt aktiviteti: import-eksport të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumenteve dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike. Import, eksport, tregtimi me shumicë, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, implanteve si dhe aksesorëve të tyre edhe gjeneratorëve me Rreze X, instalimi dhe mirëmbajtjen e të gjithë pajisjeve te cituara me sipër; Import - eksport, tregti me shumicë të materialeve, pajisjeve dhe aparaturave dentare etj. Solucione dhe materiale pastrimi etj. Investime dhe shërbime në fushën e mjekësisë dhe shëndetit, ngritja dhe menaxhimi i klinikave private. Prodhimi, shpërndarja dhe shitja e gazrave industrial, mjekësor dhe speciale si dhe te pajisjeve që lidhen me to. Ofrimin e shërbimeve te inxhinierisë (Engineering) si dhe tregtimin e materialeve dhe ofrimin e shërbimeve që kanë të bëjnë me pajisjet e prerjes dhe saldimit dhe me teknologjinë e veshjes apo shkrires si edhe kryerjen e transportit te mallrave për nevojat e veta dhe të të tretëve në Shqipëri dhe jashtë saj.

## II. Transaksioni

8. Më datë [...], mes palëve: znj Alba Rista, në cilësinë e shitësit, z. Albano Rista, në cilësinë e bashkëshortit pëlqimdhënës, dhe shoqërisë Evita SHPK, në cilësinë e blerësit, është nënshkruar dokumenti “Kontrate për shitjen e kuotës”.
9. Objekti i kontratës është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e Kuotës së zotëruar nga shitësi, e cila përfaqëson XX% të kapitalit bazë të shoqërisë DIAL-ALB SHPK, në favor te blerësit, kundrejt XX euro, sipas kushteve, afateve dhe modaliteteve te përcaktuara në këtë kontratë.
10. Në përfundim të marrëveshjes, shoqëria Evita SHPK do të jetë zotërues i një kuotë që përfaqëson XX% të kapitalit të shoqërisë dhe referuar draft/Statutit të shoqërisë target, konstatohet se shoqëria pritët të kontrollohet nga shoqëria Evita SHPK.
11. Palët kanë parashikuar [...].
12. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga

shoqëria Evita SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

13. Pala njoftuese ka deklaruar në dokumentacionin e dosjes, se shoqëria target operon në tregun e shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.
14. Mbështetur në të dhënat e administruara në procedura të mëparshme të kontrollit të përqendrime<sup>3</sup>, është evidentuar se DIAL-ALB SHPK [...]. Në të dhënat e administruara nga tatimet për vitet 2023-2024 rezulton se shoqëria është klasifikuar si shitës më shumicë të produkteve farmaceutikë
15. Nga sa reklamohet në rrjetet sociale, konstatohet se shoqëria deklarohet si përfaqësues i markës Abbot, ZARYS për materialet e konsumit mjekësor.
16. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore dhe laboratorike dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
17. Tregu i tregimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike funksionon në zbatim të ligjit nr. 89/2014, datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet kryesore për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e procesit të regjistrimit, mënyrën e shpërndarjes, vlerësimin e konformitetit, inspektimin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve mjekësore.
18. Shitja e tyre kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.
19. Nga verifikimi i bazës së të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për pajisjet mjekësorë<sup>4</sup>, shoqëria rezulton të ketë regjistruar rreth XX artikuj në regjistrin e pajisjeve mjekësore dhe nga një verifikim i listës, konstatohet se pjesa më e madhe e pajisjeve janë njëpërdorimshme.

<sup>3</sup> Rasti Nr. 69/2025 – XVI / Përfitim kontrolli, Klodian Allajbeu – Med Lab SHPK; VKK nr. 1180, datë 14.05.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Med Lab SHPK nga Z. Klodian Allajbeu”

<sup>4</sup> <https://akbpm.gov.al/>

20. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u konstatua se shoqëritë DIAL-AL SHPK dhe EVITA SHPK janë importues [...].
21. Mbështetur në vlerën e importeve të realizuar për vitin 2023-2024, konstatohet se palët pjesëmarrëse në marrëveshje, Evita SHPK ka realizuar XX% të importit të pajisjeve mjekësore me një trend [...] krahasuar me vitin 2023, ndërkohë që targeti, ndërmarrja DIAL-ALB SHPK, ka një vlerë të vogël, duke realizuar rreth XX% të importeve (me trend [...]nga viti 2023). Sipas vlerësimeve të brendshëm të realizuar nga pala njoftuese, [...].
22. Transaksioni i përfutimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga shoqëria Evita SHPK, krijon një mbivendosje horizontale në tregun e shitjes dhe mirëmbajtjes së pajisjeve mjekësore.
23. Bazuar në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, përqendrimet horizontale ndodhin në rastet kur ndërmarrjet pjesëmarrëse janë konkurrentë aktualë ose potencialë në të njëjtin treg përkatës. Për sa më sipër, transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim horizontal në tregun e tregimit të pajisjeve mjekësore dhe laboratorike.
24. Nga vlerësimi i strukturës së tregut përkatës të produktit konstatohet se palët pjesëmarrëse në transaksion, shoqëria Evita SHPK dhe DIAL-ALB SHPK, kanë realizuar importe në vlera [...] dhe për më tepër, në tregun e shitjes së materialeve mjekësore dhe laboratorike, shoqëria target zotëron [...] në treg.
25. Për sa më sipër, përfutimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga Evita SHPK nuk pritet të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të palëve pjesëmarrëse në transaksion, në tregun përkatës të produktit dhe nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë DIAL-ALB SHPK nga Evita SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr.1233, Datë 26.11.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË KAUFMANN I HOFMANN D.O.O. NGA SHOQËRITË RMF RE D.O.O., WKB 4 GMBH DHE INTERCAPITAL HICP D.O.O.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje për blerje kuotash”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: RMF RE d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit kroat, me objekt veprimtarie kryesore blerje dhe shitje e pasurive të paluajtshme

në pronësi dhe aktivitete të tjera të regjistruara si: shërbime të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së pasurive të paluajtshme, blerje dhe shitje e mallrave, ofrimi i shërbimeve në tregti, përfaqësim i shoqërive të huaja etj.

4. RMF RE d.o.o. është një shoqëri për qëllime të veçanta (SPV), e cila operon për llogari të tre fondeve të pensionit nën menaxhimin e Shoqërisë së Menaxhimit të Fondit të Pensionit të Detyrueshëm dhe Vullnetar Raiffeisen d.d. (RMF). RMF RE d.o.o. është pjesë e Raiffeisen Bank International AG, i cili ofron shërbime bankare dhe financiare universale përmes filialeve në Evropën Qendrore dhe Lindore.
5. Raiffeisen Bank International AG është aktiv në Shqipëri, përmes filialit të tij RAIFFEISEN BANK SHA dhe shoqërive të zotëruara prej saj: RAIFFEISEN LEASING SHA dhe Raiffeissen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA.
6. RAIFFEISEN BANK SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ushtrimi i veprimtarive bankare dhe financiare, si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj, sipas licencës bankare të bankës të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
7. RAIFFEISEN LEASING SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti veprimtari qeraje financiare, kredidhënie etj.
8. Raiffeissen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti administrimin e fondeve të pensionit privat nëpërmjet mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensioneve private në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
9. **Shitësi: WKB 4 GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, e cila nuk kryen asnjë aktivitet biznesi në treg, por funksionon si shoqëri holding. E vetmja shoqëri e kontrolluar nga WKB 4 GmbH është shoqëria target KAUFMANN i HOFMANN d.o.o., të cilën e zotëron në masën XX% përpara transaksionit.
10. WKB 4 GmbH bën pjesë në një grup të udhëhequr nga fondacioni [...], pronarët përfitues të të cilit janë persona fizikë.
11. Grupi fokusohet kryesisht në zhvillimin, menaxhimin dhe investimin e qendrave tregtare dhe destinacioneve të integruara me përdorim të përzier, por gjithashtu operon edhe në sektorë të tjerë, përfshirë hapësira zyresh, studio filmi dhe kredi për pasuri të patundshme.
12. **Shoqëria Target: KAUFMANN i HOFMANN d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, [...].
13. KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Shqipërisë.

14. Referuar Formularit të Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit, KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. është nën kontrollin e përbashkët të shoqërive WKB 4 GmbH (XX%) dhe InterCapital HICP d.o.o. (XX%).
15. InterCapital HICP d.o.o. (HICP) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, për menaxhimin e fondeve alternative të investimeve, e cila zotërohet 100% nga INTERKAPITAL, një shoqëri e regjistruar sipas ligjeve të Kroacisë. HICP aktualisht administron vetëm një fond alternativ investimi, të quajtur Intercapital Real Estate Fund Alfa për investime në pasuri të paluajtshme (ICRE).
16. HICP personalisht ose nëpërmjet ICRE nuk ushtron aktivitetet dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Shqipërisë.

## II. Përqendrimi

17. Ndërmjet shoqërisë RMF RE d.o.o. (blerësi) dhe shoqërisë WKB 4 GmbH (shitësi) është lidhur “Marrëveshje për blerje kuotash”, nënshkruar më datë [...].
18. Blerësi synon të blejë dhe të marrë në pronësi dhe shitësi synon të shesë dhe të transferojë kuotat objekt shitje, që përfaqësojnë XX% të kapitalit themeltar dhe të të drejtave të votës në shoqërinë target. [...].
19. Shtojca “Marrëveshja e Sipërmarrjes së Përbashkët dhe e Ortakëve”<sup>5</sup> ndërmjet shoqërisë WKB 4 GmbH (Themeluesi) dhe InterCapital HICP d.o.o. (në emër dhe për llogari të Intercapital Real Estate Fund Alfa) dhe RMF RE d.o.o. (Investitorët) [...].
20. [...].
21. Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimit ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 78 është përcaktuar se: Hyrja e aksionarëve të rinj në një ndërmarrje të kontrolluar bashkërisht ose duke shtuar numrin e aksionarëve tashmë kontrollues ose duke zëvendësuar një nga ata, gjithashtu përbën një përqendrim që duhet njoftuar, pavarësisht se ndërmarrja kontrollohet bashkërisht para dhe pas operacionit. *Së pari*, gjithashtu në këtë skenar ka një aksionar, i cili rishtazi përfton kontrollin e joint venture. *Së dyti*, cilësia e kontrollit të joint venture përcaktohet duke identifikuar të gjithë aksionarët kontrollues. Kjo shtrihet në natyrën e kontrollit të përbashkët ku secili aksionar më vete ka të drejta bllokuese në lidhje me vendime strategjike, aksionarët e përbashkët kontrollues duhet të marrin në konsideratë interesat e njëri-tjetrit dhe u kërkohet që të bashkëpunojnë për përcaktimin e sjelljeve strategjike të një sipërmarrje të përbashkët.

---

<sup>5</sup> Referuar shkresës nr. 782/3 prot. i AK, datë 28.10.2025 “Kthim përgjigje shkresës me nr. 782/2 prot., datë 10.10.2025 me Lëndë: Kërkesë Informacioni”, pjesë e dokumentit “Marrëveshje për blerje kuotash” është edhe shtojca “Marrëveshje e Sipërmarrjes së Përbashkët dhe e Ortakëve”, e cila do të nënshkruhet nga palët (ortakët) pas marrjes së miratimit të transaksionit të propozuar nga autoritetet përkatëse të mbrojtjes së konkurrencës në vendet përkatëse.

22. Duke qenë se, në shoqërinë target KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. ka hyrë një aksionar i ri kontrollues, shoqëria RMF RE d.o.o., e cila do të zotërojë në vazhdim direkt në shoqërinë target 25% të kapitalit të shoqërisë, atëherë hyrja e këtij aksionari të ri në shoqërinë target të kontrolluar bashkërisht, përbën një ndryshim kontrolli.
23. Në përfundim të transaksionit, shoqëria target KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. do të zotërohet në XX% të kapitalit nga WKB 4 GmbH; në XX% të kapitalit nga InterCapital HICP d.o.o. dhe në XX% të saj nga shoqëria RMF RE d.o.o.
24. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

25. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i dhënies me qira të hapësirave të destinuara për shitje me pakicë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
26. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.
27. Shoqëria blerëse, RMF RE d.o.o. është pjesë e Raiffeisen Bank International AG, i cili ofron shërbime bankare dhe financiare universale përmes filialeve në Evropën Qendrore dhe Lindore. Raiffeisen Bank International AG operon në Shqipëri përmes filialit të tij RAIFFEISEN BANK SH.A. dhe shoqërive të zotëruara prej saj: RAIFFEISEN LEASING SHA dhe Raiffeissen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA.
28. Shoqëria target, KAUFMANN i HOFMANN d.o.o., zotëron [...] dhe shfrytëzon këtë pasuri të patundshme, duke dhënë me qira hapësirat tregtare të ndërtuara në qendrën tregtare për subjekte të ndryshme tregtare.
29. Si shoqëria KAUFMANN i HOFMANN d.o.o. ashtu dhe shoqëritë që kontrollojnë tragetin, nuk ushtron aktivitet dhe nuk realizon të ardhura në Republikën e Shqipërisë.

30. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të përbashkët të shoqërisë KAUFMANN i HOFMMAN d.o.o. nga shoqëritë RMF RE d.o.o., WKB 4 GmbH dhe InterCapital HICP d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1241 , Datë 12.12.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË NETFONE TELECOM TÁVKÖZLÉSI ÉS SZOLGÁLTATÓ KORLÁTOLT FELELŐSSÉGŰ TÁRSASÁG NGA SHOQËRIA 4IG TÁVKÖZLÉSI HOLDING ZÁRTKÖRŰEN MŰKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim e kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje Shitblerje Kuotash të Biznesit”, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság (4iG Távközlési Holding Zrt.)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, me objekt aktiviteti kryesor [\_\_\_\_\_].

4. [\_\_\_\_\_].
5. [\_\_\_\_\_].
6. [\_\_\_\_\_].
7. **Shitësi 1: DATAMACHINE Informatika Korlátolt Felelősségű Társaság** është një shoqëri hungareze me përgjegjësi të kufizuar, e cila zotëron 49.5% të kapitalit themeltar të shoqërisë target (Kuota 1).
8. **Shitësi 2: Scanwinavia Kft.** është një shoqëri hungareze me përgjegjësi të kufizuar, e cila zotëron 24.75% të kapitalit themeltar të shoqërisë target (Kuota 2).
9. **Shitësi 3: ACS Számítástechnikai Kereskedelmi és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság** është një shoqëri hungareze me përgjegjësi të kufizuar, e cila zotëron 24.75% të kapitalit themeltar të shoqërisë target (Kuota 3).
10. **Netfone Invest Korlátolt Felelősségű Társaság** është një shoqëri hungareze me përgjegjësi të kufizuar, e cila zotëron 1% të kapitalit themeltar të shoqërisë target (Kuota e Pakicës).
11. **Shoqëria Target: Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság** është një shoqëri hungareze me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti [\_\_\_\_\_].
12. Shoqëria target [\_\_\_\_\_].

## II. Përqendrimi

13. Ndërmjet shoqërisë 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság (në cilësinë e blerësit), shoqërive DATAMACHINE Informatika Korlátolt Felelősségű Társaság, Scanwinavia Kft. dhe ACS Számítástechnikai Kereskedelmi és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (në cilësinë e shitësve) dhe Netfone Invest Korlátolt Felelősségű Társaság (Kuota e Pakicës) është lidhur “Marrëveshje Shitblerje Kuotash të Biznesit”, nënshkruar më datë 02 shtator 2025.
14. Sipas marrëveshjes ndërmjet palëve, qëllimi i blerësit është të fitojë të gjitha kuotat e shoqërisë target (100%), proces të cilin palët synojnë ta realizojnë në dy hapa. Sipas kushteve dhe dispozitave të kësaj kontrate, në datën e përmbylljes dhe me efekt nga ajo datë, shitësit ia shesin blerësit kuotat, të cilat përfaqësojnë gjithsej 99% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë target, së bashku me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lidhura me to. [\_\_\_\_\_].
15. Kuota e pakicës, që përfaqëson 1% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë target do të blihet nga blerësi në një moment të mëvonshëm.[\_\_\_\_\_]. Pas përfundimit të transaksionit, 4iG Távközlési Holding Zrt. do të zotërojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë target.
16. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e

parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i telekomunikacionit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
18. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
19. Shoqëria 4iG Távközlési Holding Zrt. [\_\_\_\_\_].
20. Shoqëria target, Netfone Telecom Kft, [\_\_\_\_\_].
21. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk pritet të sjellë ndryshime në tregun shqiptar, duke mos shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Netfone Telecom Távközlési és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság nga shoqëria 4iG Távközlési Holding Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIM**

**Nr. 1242, Datë 12.12.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË RÁBA JÁRMÚIPARI HOLDING NYRT. NGA SHOQËRIA 4IG SDT EGY ZÁRTKÖRÚEN MÚKÖDŐ RÉSZVÉNYTÁRSASÁG”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përfitim e kontrollit të shoqërisë shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Referuar dokumentit “Kontratë për shitjen e aksioneve”, nënshkruar më datë 04 shtator 2025, dhe “Kontratë për shitjen e aksioneve”, nënshkruar më datë 07 shtator 2025, palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: 4iG SDT EGY Zrt.** është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit hungarez për qëllime të transaksionit, një filial në pronësi të 4iG Ür és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság, pjesë e Grupit 4iG.
4. [\_\_\_\_\_].
5. **Shitësi 1: N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság,** [\_\_\_\_\_].
6. **Shitësi 2: Széchenyi István Egyetemért Alapítvány** [\_\_\_\_\_].
7. **Target: RÁBA Nyrt.** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit hungarez, [\_\_\_\_\_].
8. Target zotëron plotësisht dhe filialet e saj:(i) REKARD Hajtómú-és Gépgyártó e regjistruar në Győr, Hungari, (ii) Rába Járműalkatrész Gyártó és Kereskedelmi Kft., e regjistruar në Győr, Hungari, (iii) Rába Futómű Gyártó és Kereskedelmi Kft., e regjistruar në Győr, Hungari, dhe (iv) Rába Jarmű Gyártó és Kereskedelmi Kft.
9. [\_\_\_\_\_].

## II. Përqendrimi

10. 1- Ndërmjet shoqërisë 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërisë N7 HOLDING NEMZETI VÉDELMI IPARI INNOVÁCIÓS Zártkörűen Működő Részvénytársaság (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitjen e aksioneve” lidhur me Paketën e aksioneve prej 54,34%, nënshkruar më datë 04 shtator 2025.
11. Referuar kësaj Marrëveshje, objekti i kësaj Kontrate është Paketa e Aksioneve, e cila ndodhet në pronësinë ekskluzive të shitësit, me përqindje e së drejtës së votës gjithsej: 54,34%. Shitësi dëshiron ta shesë dhe blerësi dëshiron ta blejë Paketën e Aksioneve sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë. [\_\_\_\_\_].
12. [\_\_\_\_\_].
13. [\_\_\_\_\_].
14. 2- Më datë 07 shtator 2025, ndërmjet shoqërisë 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság (blerësi) dhe shoqërisë Széchenyi István Egyetemért Alapítvány (shitësi), është nënshkruar “Kontratë për shitjen e aksioneve” lidhur me Paketën e aksioneve prej 20,00%.
15. Referuar kësaj Marrëveshje, objekti i kësaj Kontrate është Paketa e Aksioneve, e cila ndodhet në pronësinë ekskluzive të shitësit, me përqindje e së drejtës së votës gjithsej: 20,18%. Shitësi dëshiron ta shesë dhe blerësi dëshiron ta blejë Paketën e Aksioneve sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë. [\_\_\_\_\_].

16. Sipas deklaramit të palës njoftuese pjesa e mbetur prej 24.77% e aksioneve do tregtohet publikisht, ndërsa 0.89% janë aksione të vetë shoqërisë. Palët kanë rënë dakord që blerësi synon të blejë gjithsej nga të dy shitësit kapitalin aksionar të shoqërisë target, që përbën në total 74.34% të kuotave.
17. [\_\_\_\_\_].
18. Në përfundim, 4iG SDT EGY Zrt. do të përfitojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë target Rába Járműipari Holding Nyrt., me 4iG Ür és Védelmi Technológiák Zártkörűen Működő Részvénytársaság si blerësi përfundimtar.
19. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës

### **III. Analiza e konkurrencës**

20. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të automjeteve të mbrojtjes dhe ushtarake, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
21. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
22. 4iG SDT EGY Zrt. është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit hungarez për qëllime të transaksionit, pjesë e Grupit 4iG. [\_\_\_\_\_].
23. Shoqëria target, RÁBA Nyrt. është një shoqëri aksionare, [\_\_\_\_\_].
24. [\_\_\_\_\_]
25. Në përfundim të analizës, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk pritët të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar mbi përfitim të kontrollit të shoqërisë Rába Járműipari Holding Nyrt. nga shoqëria 4iG SDT EGY Zártkörűen Működő Részvénytársaság.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1243, Datë 12.12.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË AI SIRONA (LUXEMBOURG) ACQUISITION S.À R.L. NGA SHOQËRIA ALTHEA ACQUISITION BIDCO S.À R.L.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l.”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l.
2. Referuar dokumentit “Marrëveshje në lidhje me shitblerjen e AI Sirona (Luksemburg) Acquisition S.à r.l.”, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:

3. **Blerësi: Althea Acquisition Bidco S.à r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: [...]
4. Althea kontrollohet nga fondet e administruara nga shoqëri të lidhura me GTCR LLC, një shoqëri private investimesh e fokusuar në investimin në [...].
5. GTCR nuk ka prezencë ligjore por ka realizuar xhiro në Shqipëri.
6. **Shitësi: AI Sirona (Luxembourg) Subco S.à r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut.
7. **Shoqëria Target: AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me objekt aktiviteti: [...].
8. Target është një shoqëri me qëllim të veçantë (special purpose vehicle), e cila administron grupin e shoqërive Zentiva, aktive në [...].
9. Grupi Target është i pranishëm në Shqipëri përmes Zentiva Pharma Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: regjistrimi, promovimi, importi, shpërndarja dhe shitja e produkteve farmaceutike dietike dhe i çdo produkti tjetër si dhe i pajisjeve mjekësore; veprimtari ndërmjetësimi dhe agjenci; veprimtari në fushën e këshillimit, reklamave etj.

## II. Përqendrimi

10. Ndërmjet shoqërisë Althea Acquisition Bidco S.à r.l. (në cilësinë e blerësit), shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Subco S.à r.l. (në cilësinë e shitësit) dhe në prani të AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. (Shoqëria) është lidhur “Marrëveshje në lidhje me shitblerjen e AI Sirona (Luksemburg) Acquisition S.à r.l.”, nënshkruar më datë [...].
11. Në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje, shitësi do të shesë dhe blerësi do të blejë kuotat (të cilat përfaqësojnë të gjithë kapitalin e emetuar të shoqërisë target), të lira nga çdo e drejtë e palëve të treta, duke hyrë në fuqi nga finalizimi, me garanci të plotë mbi pronësinë dhe me të gjitha të drejtat që burojnë prej tyre.
12. Finalizimi i transaksionit i nënshtrohet përmbushjes së kushteve të përcaktuara në marrëveshje.
13. Pas përfundimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target do të kontrollohet nga Althea Acquisition Bidco S.à r.l.
14. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfundimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë

28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i regjistrimit, promovimit, importit, shpërndarjes dhe shitjes së produkteve farmaceutike etj, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l.
17. Blerësi, Althea Acquisition Bidco S.à r.l. është një shoqëri holding, e cila kontrollohet nga fondet e administruara nga shoqëri të lidhura me GTCR LLC, një shoqëri private investimesh e fokusuar në investimin në shoqëri në zhvillim në industrinë e [...].
18. Shoqëria target, AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l., është një shoqëri e krijuar për qëllime të transaksionit, e cila administron grupin e shoqërive Zentiva, aktive në [...].
19. Grupi Target është i pranishëm në Shqipëri përmes Zentiva Pharma Albania SHPK, e cila operon në regjistrimin dhe promovimin e produkteve farmaceutike edhe i pajisjeve mjekësore.
20. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

### VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë AI Sirona (Luxembourg) Acquisition S.à r.l. nga shoqëria Althea Acquisition Bidco S.à r.l.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr.1244 , Datë 12.12.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË TRING TV SHA NGA SHOQËRIA VERTEX HOLDING SHPK”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmartjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12. 2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të procedurës së thelluar të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK,

**VËREN SE :**

**I. Procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 879 prot. i AK, datë 06.10.2025 “Njoftim përqendrimi”, është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi blerjen e 100% të aksioneve të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.
2. Pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se:

- a. shoqëria blerëse nuk ka aktivitet (shoqëri holding) dhe nuk ka eksperiencë të mëhershme në tregun e media audiovizive;
  - b. tregu përkatës i produktit, tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, me pagesë, ka karakteristikat e një tregu duopol;
  - c. mungesë e një informacioni të plotë për të vlerësuar mundësinë reale të blerësit për të ushtruar aftësitë funksionale dhe për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target;
  - d. domosdoshmërinë e kryerjes së një analizë më të thelluar të ndikimit dhe pasojave në tregun përkatës të produktit dhe vlerësimin e efekteve të transaksionit mbi konkurrencën në treg.
3. Mbështetur në nenin 56 pika 1, germa b) dhe nenit 57 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës me Vendimit nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, vendosi:
1. Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.
  2. Raporti i procedurës së thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 muaj nga data e marrjes së këtij vendimit.
4. Procedura e thelluar në rastet e kontrollit të përqendrimeve, sipas parashikimeve të nenit 57 të ligjit, konsiston në kryerjen e analizave më të thelluara ekonomike dhe të efekteve që ky përqendrim sjell në treg. Gjatë kësaj procedure dhe kur ka dyshime apo shfaqen shqetësimi se ky transaksion mund të kufizojë konkurrencën në treg, kërkohet një informacion më i detajuar, përfshirë edhe dokumente të brendshme të vetë ndërmarrjes apo edhe pyetësorë.
5. Gjithashtu gjatë kësaj faze, Autoriteti i Konkurrencës analizon eficientat e pritshme të pretenduara nga ndërmarrja si pasojë e këtij përqendrimi dhe nëse ka efekte pozitive të këtyre eficientave tek konsumatorët, të cilat tejkalojnë ato efekte që mendohen se shkelin parimet e konkurrencës, atëherë përqendrimi autorizohet. Këto eficienta duhet të përmbushin kushtet dhe barra e provës bie mbi ndërmarrjet palë në transaksion për të provuar se këto eficienta janë plotësuar. Sipas parashikimeve të pikës VII “Eficientat” të Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, së pari këto eficienta duhet të jenë të verifikueshme, specifike lidhur me këtë përqendrim dhe eficientat duhet të sjellin përfitime për konsumatorët.
6. Në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, Sekretariati me shkresën nr. 879/10 datë 30.10.2025 “Kërkesë për informacion” ka kërkuar palës njoftuese informacion shtesë në lidhje me: plotësimin e Formularit të Plotë të Njoftimit të Përqendrimit; informacion mbi

burimin e të ardhurave, të cilat do të shërbejnë për të paguar çmimin e blerjes, të përcaktuar në marrëveshje, si dhe plani i biznesit afatshkurtër dhe afat mesën i shoqërisë blerëse në lidhje me vijimësinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target.

7. Shoqëria Vertex Holding SHPK, nëpërmjet shkresës nr. 879/11 prot., i AK datë 06.11.2025 “Ankim Administrativ”, ka kërkuar nga Komisioni i Konkurrencës revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK” dhe vijimin e procedurës sipas Formularit të Thjeshtuar.
8. Gjatë vlerësimit të dokumentacionit të depozituar, Autoriteti i Konkurrencës konstatoi fakte të reja dhe me shkresën nr. 879/13, prot., i AK, datë 18.11.2025 “Kërkesë për informacion”, informoi përfaqësuesin ligjor dhe shoqërisë Vertex Holding SHPK, se dokumentacioni i depozituar prej tyre ishte i paplotë dhe në zbatim të nenit 55 të ligjit, i kërkoi palës njoftuese depozitim të Formularit të Plotë të Njoftimit të Përqendrimit; informacion mbi burimin e të ardhurave, të cilat do të shërbejnë për të paguar çmimin e blerjes, të përcaktuar në marrëveshje; plani i biznesit afatshkurtër dhe afat mesën i shoqërisë blerëse në lidhje me vijimësinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target; ekstraktet e shoqërive ARTMOTION SHPK dhe EUROLAB SHPK, dhe çdo dokument tjetër i cili të tregojë lidhjen e z. Valon Shala, si përfitues fundor në këto shoqëri, si dhe informacion mbi aktivitetin e shoqërisë ARTMOTION SHPK në tregun e transmetimeve kabllore dhe sa do të preket ky aktivitet nga transaksioni i përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA.
9. Pala njoftuese, me shkresën nr. 879/14 prot., i AK, datë 25.11.2025, “Depozitim i dokumenteve plotësuese”, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dokumentacionin e kërkuar.
10. Autoriteti i Konkurrencës, me shkresën nr. 879/15 prot., i AK, datë 05.12.2025 “Dërgohet konfirmimi i marrjes së njoftimit”, ka konfirmuar marrjen e njoftimit të përqendrimit dhe, pas vlerësimit të dokumentacionit të dosjes, ka informuar shoqërinë se po fillon procedura e kontrollit të këtij përqendrimi.

## **II. Vlerësimi i Ankimit Administrativ**

11. Shoqëria Vertex Holding SHPK, e përfaqësuar ligjërisht nga përfaqësuesi ligjor i autorizuar prej saj, nëpërmjet shkresës nr. 879/11 prot., i AK datë 06.11.2025 “Ankim Administrativ”, ka kërkuar nga Komisioni i Konkurrencës revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK” dhe vijimin e procedurës sipas Formularit të Thjeshtuar.
12. Komisioni Konkurrencës, vlerësoi argumentimet ligjore mbi pretendimet e ngritura nga Pala Njoftuese si vijon:

**Pretendimi 1.** *Njoftimi dhe Formulari i Thjeshtuar janë plotësisht në përputhje me parashikimet*

*e nenit 56 të Ligjit “Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit dhe forcimit të pozitës dominuese, komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit”.*

13. Në kuptim të nenit 13 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në zbatim të “Udhëzimit për Vlerësimin e Përqendrimeve jo Horizontale dhe Konglomerate”, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson të gjitha ato përqendrimet që janë në përputhje me qëllimin e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Në këtë kontekst, **Autoriteti i Konkurrencës vlerëson nëse një përqendrim pengon ndjeshëm ose jo konkurrencën efektive**, në veçanti si rezultat i krijimit ose forcimit të një pozicioni dominant, në tregun e brendshëm ose në një pjesë të ndjeshme të tij.
14. Konkurrenca efektive duhet të sjellë përfitime për konsumatorët, të tilla si: ulje të çmimeve, cilësi më të lartë të produkteve, mundësi më të mëdha zgjedhjeje dhe të shpikjeve. Nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve, Komisioni i Konkurrencës ndalon ato përqendrimet që krijojnë ose forcojnë në mënyrë të ndjeshme **fuqinë e tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në to**, duke i privuar konsumatorët nga këto përfitime.
15. Me “rritje të fuqisë së tregut” nënkuptohet aftësia e një ose më shumë ndërmarrjeve, për të përfituar nga rritja e çmimeve, ulja e prodhimit, ulja e mundësive së zgjedhjes, ulja e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve, zvogëlimi i shpikjeve apo ndikime negative mbi parametrat e konkurrencës.

**Pretendimi 2.** *Udhëzimi i AK-së “ Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit 9121 datë 23.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës” përcakton se: Autoriteti në përgjithësi i konsideron pjesët e vogla të tregut si një tregues i mirë për mungesën e fuqisë së rëndësishme të tregut. Eksperienca e vendeve të Komitetit Evropian tregon se pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës e ndërmarrjes është më e vogël se 40%.....*

16. Lidhur sa është përmendur më sipër, pika II “**Fuqia e tregut**”, germa a), 2 e Udhëzimit “Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të Ligjit 9121 datë 23.07.2003 “ Për Mbrojtjen e Konkurrencës” vazhdon: “ Pozicioni në treg i ndërmarrjeve me pozitë dominuese dhe konkurrentëve”, vazhdon: Sidoqoftë, ka shumë raste specifike **poshtë këtij pragu** ku konkurrentët nuk janë në një pozicion të tillë që të kufizojnë sjelljen e një ndërmarrjeje me pozitë dominuese, për shembull kur ato përballen me kufizime të rëndësishme kapacitetesh. **Të tilla raste duhet të vlerësohen nga ana e Autoritetit. Si rregull i përgjithshëm, Autoriteti nuk del me një konkluzion përfundimtar pa analizuar të gjithë faktorët e rëndësishëm, të cilët mund të kufizojnë sjelljen e një ndërmarrjeje.**

17. Gjithashtu po në seksionin II, pika b), 1) sqarohet se: Konkurrenca është një proces dinamik dhe një vlerësim i kufizimeve të konkurrencës së një ndërmarrje nuk mund të bazohet vetëm në situatën aktuale të tregut. Ndikimi i mundshëm i zgjerimit të konkurrentëve aktual ose hyrja e konkurrentëve potencial, përfshirë këtu dhe riskun e zgjerimit dhe **hyrjes së konkurrentëve të rinj, është gjithashtu i mundshëm.**
18. Zgjerimi ose hyrja e mundshme e një konkurrenti në treg, duhet të jetë mjaftueshëmrisht fitimprurëse për konkurrentin ose hyrësin, në mënyrë që **Autoriteti të marrë në konsideratë, faktorë të tillë si barrierat e zgjerimit ose hyrjes, reagimet e mundshme të ndërmarrjes që pretendon të jetë me pozitë dominuese dhe konkurrentëve të tjerë, si dhe riskun dhe kostot e falimentimit.**
19. Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të detyrave të tij funksionale, me nismën e tij, me kërkesën e Kuvendit ose me kërkesën e institucioneve rregullatorë përkatës, kryen procedura hetimore, kur vëren shenja të kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në treg.

**Pretendimi 3.** *Në zbatim të nenit 109 e në vijim të KPA kërkojmë revokimin e vendimit të nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, duke e konsideruar këtë Vendim si të nxjerrë në kundërshtim të hapur me ligjin.*

20. Lidhur me sa më sipër, pretendimi i ngritur bie ndesh me Nenin 24, “Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit”, ku në pikën d sqarohet se: Komisioni i Konkurrencës merr vendime sipas këtij ligji dhe neni 56 “Procedura paraprake”, citon: 1. Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.
21. Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të tilla, komisioni vendos: a) autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime; b) fillimin e procedurës së thelluar. Pika 1 e nenit 57 “Procedura e thelluar” citon: Komisioni vendos të ndalojë ose jo përqendrimin brenda një periudhe prej tre muajsh nga fillimi i procedurës së thelluar.
22. Ndërsa “Revokimi” i një Vendimi referuar nenit 63 të ligjit nr. 9121/2003, ndodh në rastet:
- a) është marrë në bazë të dhënave jo të sakta të ndërmarrjeve pjesëmarrëse;
  - b) është marrë me anë të mashtrimit;
  - c) ndërmarrjet pjesëmarrëse shkelin një ose disa detyrime të parashikuara në autorizim.
23. **Për sa u arsyetua më sipër**, nuk gjen vend pretendimi i palës njoftuese mbi revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”

**Pretendimi 4.** *Në pjesën arsyetuese të Vendimit të AK nuk ka dhënë arsyetim se jemi para këtyre kushteve, e se cilat janë këto shenja të kufizimit e madje në mënyrë të ndjeshme të tregut nga një operator që as nuk zotëron pozitë dominuese.*

24. Në lidhje me sa pretendohet, në pjesën arsyetuese të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfutimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, është sqaruar se:

- Nisur nga struktura e tregut përkatës, mungesa e një informacioni të plotë për të vlerësuar mundësinë reale të blerësit për të ushtruar aftësitë funksionale dhe për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target, me qëllim vlerësimin e efekteve të transaksionit mbi konkurrencën në treg, kërkohet një analizë më të thelluar e ndikimit dhe pasojave në tregun përkatës të produktit.
- Sipas parashikimeve të nenit 56 “Procedura paraprake” të Ligjit 9121/2003, në rastet kur ka dyshime se potencialisht përqendrimi mund të shfaqë shenja anti konkurruese, vendoset fillimi i procedurës së thelluar.
- Procedura e thelluar në rastet e kontrollit të përqendrimeve, sipas parashikimeve të nenit 57 të ligjit, ka të bëjë më kryerjen e analizave më të thelluara ekonomike dhe të efekteve që ky përqendrim sjell në treg. Gjatë kësaj procedure dhe kur ka dyshime apo shfaqen shqetësimi se ky transaksion mund të kufizojë konkurrencën në treg, kërkohet një informacion më i detajuar, përfshirë edhe dokumente të brendshme të vetë ndërmarrjes apo edhe pyetësorë.
- Gjithashtu gjatë kësaj faze, analizohen eficientat e pritshme të pretenduara nga ndërmarrja si pasojë e këtij përqendrimi dhe nëse ka efekte pozitive të këtyre eficientave tek konsumatorët, të cilat tejkalojnë ato efekte që mendohen se shkelin parimet e konkurrencës, atëherë përqendrimi autorizohet.
- Këto eficienta duhet të përmbushin kushtet dhe barra e provës bie mbi ndërmarrjet palë në transaksion për të provuar se këto eficienta janë plotësuar. Sipas parashikimeve të pikës VII “Eficientat” të Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve horizontale”, së pari këto eficienta duhet të jenë të verifikueshme, specifike lidhur me këtë përqendrim dhe eficientat duhet të sjellin përfitime për konsumatorët.

25. Arsyetimi i mësipërm është mbështetur në vlerësimin e të gjithë elementëve të parashikuar në nenin 8 “Vlerësimi i pozitës dominuese” dhe nenin 13 “Vlerësimi i përqendrimit” të parashikuar në ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës.

**Pretendim 5:** *Mosdepozitimin e Formularit të Plotë të Njoftimit,*

26. Udhëzimi “Mbi Formën e Njoftimit të Përqendrimit”, sipas pikës 8 “Njoftimi sipas Formularit të Plotë të Njoftimit”, citon konkretisht rastet kur duhet plotësuar *Formularit të Plotë të Njoftimit*.

27. Shembuj të domosdoshmërisë të përdorimit të Formularit të Plotë të Njoftimit, janë ato raste të përqendrimeve, ku është e vështirë të përcaktohen tregjet përkatëse, për shembull: -tregjet në zhvillim; -kur një palë është një hyrës i ri ose potencial, ose një zotërues i rëndësishëm patente; -kur nuk është e mundur të përcaktohen rregullisht pjesët e tregut të palëve; -në tregjet me barriera të lartë hyrjeje, -në tregje me një shkallë të lartë përqendrimi ose me probleme të njohura konkurrence; -kur të paktën dy palë në përqendrim janë të pranishme në tregjet fqinjë ngushtësisht të lidhur; dhe -në përqendrime që mundësojnë koordinimin e sjelljes së ndërmarrjeve të treg.

**Pretendim 6:** *Z.Valon Shala pretendon për një gabim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, ku është cituar se: “Ortak i vetëm i shoqërisë blerëse është z.Valon Shala me 100% të aksioneve, i cili ka deklaruar se nuk zotëron shoqëri të tjera si brenda territorit shqiptar dhe jashtë saj”.*

28. Lidhur me këtë pretendim, i cili nuk është i saktë, sqarojmë se: në Seksioni 4 “Pronësia dhe kontrolli”, Aneksin 1 “Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimeve”, kërkohet të deklarohet *“Për secilën prej palët pjesëmarrëse në përqendrim paraqisni një listë të të gjitha ndërmarrjeve që i takojnë të njëjtit grup. Kjo listë duhet të përfshijë: 4.1.1. Të gjitha ndërmarrjet ose personat që kontrollojnë palët pjesëmarrëse në përqendrim, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;”*. Pala njoftuese ka deklaruar vetëm *“Aksionerët e lidhur me Shitësin”* dhe në pikën 4.1.2 shprehet: *Transaksioni nuk ka tregje te prekura, pasi Blerësi është shoqëri e re e sapo krijuar në treg.*

29. Për të qartësuar këtë informacion, me shkresën nr. 879/1 prot., i AK datë 06.10.2025 “Kërkesë për informacion”, Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar përfaqësuesit ligjor informacione shtese, shprehimisht: **Informacion mbi shoqëritë, e kontrolluara direkt apo indirekt nga ortaku i shoqërisë Vertex Holding SHPK**, informacion i cili duhej të ishte plotësuar domosdoshmërisht edhe në Formulari i Thjeshtuar i Njoftimit të Përqendrimeve, të paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës.

30. Nga pala njoftuese me shkresën nr. 879/2 prot., i AK datë 13.10.2025, “ Depozitimi i Dokumenteve Plotësuese për Njoftimin e Përqendrimit”, ka depozituar **deklaratë** nga deklaruesi z.Valon Shala ku shprehet si më poshtë: *Unë i nënshkruari Valon Shala, ortaku vetëm i shoqërisë Vertex Holding SHPK, sipas parashikimeve të nenit 2.1.b të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar) deklaroj se aktualisht (tetor 2025) përveç Vertex Holding SHPK, nuk zotëroj shoqëri të tjera të kontrolluara direkt ose indirekt që e ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe as shoqëri që e ushtrojnë veprimtarinë jashtë këtij territori, që të kenë pasoja të kësaj veprimtarie që të ndihen në tregun e brendshëm gjeografik (Republika e Shqipërisë).*

31. Deklarata e z. Valon Shala, ka qenë një nga arsyet që ndikoi në vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, të cilët gjykuan se procedura e thelluar do të mundësonte vlerësimin e aftësive/ mundësisë reale të blerësit për të ushtruar aftësitë funksionale dhe për të siguruar vijueshmërinë e aktivitetit ekonomik të shoqërisë target.
32. Bashkëlidhur shkresës nr. 879/11 prot., i AK datë 06.11.2025 “Ankim Administrativ”, z. Shala ka depozituar një shkresë me lëndë: “Përgjigje ndaj kërkesës për informacion shtesë në kuadër të njoftimit për përqendrim me shkresën nr. 879, lidhur me transaksionin për fitimin e kontrollit mbi Tring sha”, në të cilën ka deklaruar se ka në pronësi fundore dy shoqëri në Kosovë, Artmotion SHPK, me aktivitet në telekomunikimin kabllor dhe shoqërinë Eurolab shpk, me aktivitet në kërkim dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat e natyrës dhe inxhinierike, ndërkaq aktiviteti dytësor ka testimin teknik dhe analizat.
33. Komisioni i Konkurrencës pasi u njoh me Ankimin Administrativ të përfaqësuesit ligjor, lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1225, datë 29.10.2025, “Për fillimin e procedurës së thelluar për transaksionin e propozuar të përfuturit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK”, konstatoi se pala ankimuese nuk ka sjellë asnjë prove apo fakt, e cila të krijojë bindjen e arsyeshme që vendimmarrja e Komisionit mund të jetë marrë mbi bazën e të dhënave jo të sakta të ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe për këto arsye, nuk është në kushtet e revokimit të një vendimi sipas parashikimit të nenit 63, germa a) të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

### III. Palët në marrëveshje

34. Referuar dokumentit “Kontratë Shitje dhe Blerje Aksionesh”, nënshkruar më datë 02 tetor 2025, palët në marrëveshje janë:
35. **Blerësi: Vertex Holding SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e aktiviteteve të shoqërive holding. Shitblerje aksionesh. Përveç kësaj në përputhje me legjislacionin shqiptar, shoqëria mund të kryej çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që është rezultat ose lidhet me objektivin e mësipërm. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qeraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i shoqërisë.
36. Ortak i vetëm i shoqërisë blerëse është z.Valon Shala me 100% të aksioneve dhe referuar dokumentacionit të depozituar me shkresën nr. 879/14 prot., i AK, datë 25.11.2025, “Depozitim i dokumenteve plotësuese”, z.Valon Shala zotëron paketën kontrolluese në shoqëritë:
  - [...]
  - [...]

37. **Shitësi: CONCORD INVESTMENT SHPK** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar dhe objekt aktiviteti: Investimi, zbatimi, zhvillimi, menaxhimi i zonave civile, industriale, turistike, si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to. Kryerja e veprimtarive tregtare në fushën e ndërtimit, për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndërtimit. Kryerja e aktivitetit për investimin në fushën e ndërtimit, në komplekse civile, turistike, industriale, sociale, komplekseve të tregtimit dhe të shërbimit bar-restorant-hoteleri etj. Pjesëmarrje në projekte ndërtimore, si sipërmarrës, investitor, konsulent, si dhe marrjen përsipër të menaxhimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjetër për ndërtim. Zhvillimi dhe ndërmjetësimi i projekteve për rikonstruksionin e ndërmarrjeve industriale. Kontraktimi me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj për gjetjen e tregjeve të shitjes për prodhimet dhe punë të shoqërisë. Blerje-Shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme (prona të ndryshme, si trojë, toka bujqësore, apartamente banimi, ambiente shërbimi dhe tregtimi etj., pasuri këto në pronësi të shoqërisë ose në pronësi të shoqërive të tjera, personave fizikë apo juridike, të cilët e autorizojnë për përfaqësim shoqërinë, për blerje-shitje.
38. Concord Investmen SHPK, kontrollohet nga ortakët Adrian Dulaku me 33,00% të aksioneve, Artan Dulaku me 34,00% të aksioneve, Genci Dulaku me 33,00% të aksioneve.
39. **Shoqëria Target: Tring TV SHA** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Veprimtari ekskluzive audiovizive. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në ndërtimin e sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve audiovizive dhe ripërsëritjen e tyre në çdo lloji transmetimi (satelitor tokësor, kabllor, IPTV,OTT, Internet TV) në formë të koduar apo të pakoduar, me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllove, përsëritësve, sateliteve apo me çdo mjet tjetër. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në tregtimin e aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së valëve audiovizive. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në ndërtimin dhe shfrytëzimin e rrjeteve numerike, për transmetimin satelitor, tokësor, kabllor IPTV, OTT, Internet TV me qëllim ofrimin e shërbimit të transmetimit për publikun. Në funksion të veprimtarisë ekskluzive audiovizive ushtron dhe veprimtari në prodhimin, transmetimin, ritransmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve dhe shërbimeve audio e video. etj.
40. Shoqëria target kontrollohet drejtpërdrejt nga shoqëria Concord Investmen SHPK me 100% të aksioneve.
41. Shoqëria Tring Tv SHA është e licencuar nga AMA me certifikatën Nr. 2012-AP-U233-8-3 15.05.2012 dhe Nr. 2014-AP-U233-8-3 06.02.2015 për: -Shërbime publike të komunikimeve

elektronike; -Shërbime të tjera të komunikimeve elektronike; - Shërbimet me vlerë të shtuar; - Mesazhe zanore/jozanore; - Rrjete publike me transmetim satelitor; - Rrjete fikse (pajisje terminal VSAT).

#### **IV. Transaksioni**

42. Më datë 02 tetor 2025, shoqëria Vertex Holding SHPK (blerësi), CONCORD INVESTMENT SHPK (shitësi), kanë nënshkruar “Kontratë Shitje dhe Blerje Aksionesh”.
43. Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi ka rënë dakord të shesë tek blerësi të gjitha aksionet të cilat ai zotëron tek shoqëria target dhe blerësi ka rënë dakord të blejë këto aksione, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshje. Aksionet do të shiten nga shitësi dhe do të blihen nga blerësi duke transferuar njëkohësisht titullin dhe pronësinë mbi aksionet nga shitësi tek blerësi, me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së aksioneve dhe kryerjes së pagesës siç parashikohet në këtë kontratë. Blerësi ka kryer procesin e “Due Diligence” dhe bie dakord të blejë aksionet e shoqërisë në gjendjen që shoqëria është, pa asnjë pretendim ndaj shitësit.
44. Si kushte paraprake, shitësi dhe blerësi kanë miratuar organet e tyre vendimmarrëse sipas statutit të tyre;(i) miratimin e shitjes/blerjes së aksioneve respektive nga shitësi tek blerësi dhe (ii) miratimin e nënshkrimit të Kontratës së Shitblerjes dhe transferimin e aksioneve. Gjithashtu blerësi do të ndjekë procedurat e njoftimit për ndryshimin e pronësisë pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, etj.
45. Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate, blerësi është njohur dhe ka pranuar:  
[...]
46. [...]
47. Palët bien dakord që brenda afateve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, aksionet do të jenë të lira nga çdo barrë.
48. Sipas nenit 3 “Përfundimi i Shitblerjes së Aksioneve”, palët nënshkruese kanë përcaktuar se: Marrëveshja hyn në fuqi dhe konsiderohet e përmbushur nga ana e blerësit në momentin që Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë miratimin për ndryshimin e pronësisë dhe vlera e çmimit të blerjes është e disponueshme/është kredituar në llogarinë bankare të shitësit pa kufizim.
49. Me kalimin e pronësisë së aksioneve nga shitësi tek blerësi, ky i fundit do të jetë aksionari i ri, i vetëm i shoqërisë target dhe do të zotërojë 100.000 aksione të shoqërisë që përfaqësojnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë dhe shitësi nuk do të jetë më aksionar i shoqërisë target.
50. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

#### **V. Analiza e konkurrencës**

51. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, me pagesë, dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
52. Veprimtaria e mediave audiovizive, që operojnë në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjor dalë për zbatim të tij. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) është institucioni përgjegjës për monitorimin dhe rregullimin e tregut mediatik në Shqipëri.
53. AMA lëshon Autorizim për kryerjen e shërbimit të programit audioviziv, kur shërbimi është:  
a) satelitor, kur mbështetet në një sistem satelitor; b) kabllor, kur mbështetet në një sistem kabllor; c) shërbimi on line, kur mbështetet në internet.
54. Transmetimet televizive në Shqipëri janë në një masë të madhe të liberalizuara. Ato realizohen në forma të ndryshme qoftë në transmetime të hapura analoge tokësore apo satelitore, qoftë numerike tokësore apo satelitore dhe kabllore. Operatorët televizivë që kryejnë transmetime të përmbajtjes televizive janë gjerësisht të përhapur, jo vetëm, por transmetime të përmbajtjes televizive kryhen dhe në internet apo ndërmjet IPTV, ku operatorët e shpërndarjes së internetit në Shqipëri janë të shumtë.
55. Shërbimi i transmetimit të kanaleve në platformën digjitale tokësore dhe satelitore ka hyrë si risi në vitin 2004 nga shoqëria DigitAlb SHA.
56. Ndërkohë, shoqëria Tring TV SHA operon me 10 njësi shitjeje me markën Tring dhe bashkëpunon me mbi 130 pika partnere në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu ka një rrjet ndërkombëtar shpërndarjeje me partnerë të autorizuar në Mal të Zi, Kosovë, Greqi, Maqedoninë e Veriut, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Itali, Francë dhe Suedi.
57. Tring Tv SHA operon në tregun e televizionit me pagesë si (i) një operator distributor paketash me kanale (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit numerik dhe rrjetit satelitor, si dhe transmetues nëpërmjet rrjetit kabllor dhe IPTV-së. Pra, Tring transmeton përmbajtjet televizive me pagesë mbështetur në frekuenca ashtu edhe mbështetur në rrjet komunikimi elektronik (kabëll ose IPTV). Tring Tv SHA ka në kanalet e saj operatorin kombëtar Vizion Plus.
58. DigitAlb SHA është konkurrenti i vetëm direkt i Tring Tv SHA në tregun e televizionit me pagesë. Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore dhe satelitore. DigitAlb SHA është operatori kryesor që vepron në televizionin me pagesë në Shqipëri. DigitAlb është njëkohësisht (i) një operator distributor

paketash me kanale; (ii) një operator editues kanalesh me pagesë (që ka përgjegjësi editoriale mbi përmbajtjet e përfshira), (iii) prodhues veprash të ndryshme intelektuale; si dhe (iv) transmetues nëpërmjet rrjetit të tij numerik me shtrirje kombëtare, si dhe nëpërmjet rrjetit satelitor. Në rolin e tij si transmetues, DigitAlb SHA transmeton përmbajtjet televizive me pagesë nëpërmjet teknologjive që mbështeten në frekuenca, konkretisht: (i) DigitAlb siguron mbulim kombëtar nëpërmjet rrjetit të tij tokësor numerik; si dhe (ii) siguron mbulim kombëtar dhe ndërkombëtar me transmetim satelitor.

59. Këto dy platforma, DigitAlb dhe Tring, krijojnë kontent dhe operojnë në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllorë (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor).
60. Referuar të ardhurave të realizuar në tregun e prodhimit transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video nga dy konkurrentet në treg, vihet re një ulje e tyre gjatë vitit 2024. Ndërmarrja DigitAlb SHA zë një pjesë tregu prej xx% në bazë të xhiros së realizuar, ndërsa ndërmarrja Tring SHA zë xx% të tregut në bazë të xhiros së realizuar. Për vitin 2023 ndërmarrja DigitAlb SHA zë një pjesë tregu prej xx% në bazë të xhiros së realizuar, ndërsa shoqëria Tring SHA zë xx% të tregut në bazë të xhiros së realizuar.
61. Ndërkohë, në tregun e televizionit me pagesë veprojnë edhe operatorët kabllorë, të licencuar si ripërsëritës programi, të cilët transmetojnë vetëm nëpërmjet teknologjive që nuk mbështeten në frekuenca (kabëll, rrjet komunikimesh elektronike, IPTV, etj). Operatorët kabllorë nuk prodhojnë, editojnë, apo janë distributorë të mirëfilltë, këta operatorë janë thjesht shpërndarës të programeve të të tretëve dhe në këto kushte mbeten shpërndarës të programeve të ofruara nga DigitAlb dhe Tring, duke përdorur rrjetin e tyre kabllor. Sipas të dhënave të administruara nga AMA për vitin 2024 janë 66 operatorë kabllorë të licencuar.
62. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK dhe u klasifikua si një përqendrim konglomerat, në tregun e brendshëm, pasi palët pjesëmarrëse në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.
63. Shoqëria Vertex Holding SHPK është një shoqëri e krijuar rishtazi për të funksionuar si shoqëri holding. Ortaku i shoqërisë Vertex Holding SHPK është përfitues fundor në shoqëritë [...].
64. Shoqëria Tring Tv SHA operon në tregun e transmetimeve televizive me pagesë.
65. Mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, në përgjithësi përqendrimet konglomerate kanë më pak mundësi të krijojnë shqetësime për konkurrencën, pasi *së pari* ato nuk shkaktojnë humbjen e një konkurrenti, pasi ndërmarrjet nuk veprojnë në të njëjtin treg përkatës (përqendrimet horizontale) dhe *së dyti*, përqendrimet vertikale dhe konglomerate sigurojnë mundësi reale për efijensat.
66. Për të vlerësuar efektet e mundshme antikonkurruese, është vlerësuar nëse shoqëria target, pas

përqendrimit: a) ka aftësinë për të përjashtuar konkurrentët e saj; b) ka nxitjen ekonomike për të bërë këtë; c) ka një strategji të përjashtimit, e cila mund të sjellë një efekt të dëmshëm mbi konkurrencën dhe konsumatorët.

67. Nga shqyrtimi i rastit, konstatohet se pala blerëse është një shoqëri e krijuar rishtazi, pa prezencë ekonomike në Shqipëri dhe nuk pritet të ketë drejtpërdrejtë aftësinë për të përjashtuar konkurrentin tjetër nëpërmjet praktikave të kushtëzuara apo të lidhura. Pala blerëse, nëpërmjet shoqërisë [...], sjell në shoqërinë Tring TV SHA *know how* nga tregu i transmetimeve televizive në [...].

68. Nga analiza e strukturës së tregut, konstatohet se tregu i prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, me pagesë, ka karakteristikat e një tregu duopol, me ndërmarrje me fuqi tregu. Palët në transaksion duhet të japin siguri për vijimësinë aktivitetit të shoqërisë target dhe rritjen e eficensës dhe aftësisë konkurruese të saj.

69. Për këtë qëllim dhe nga vlerësimi i dokumentacionit u konstatua se:

- Shoqëria Tring rezulton një normë fitimi të ulët, vetëm xx% dhe një kthim investimi shumë të ulët. Referuar çmimit të shitjes së paketave konstatohet se çmimi i paketave digjitale të ofruara nga Tring janë më të ulta se DigitAlb, por treguesit financiar tregojnë se Tring nuk është në gjendje të konkurrojë.
- [...]
- Shoqëria [...], është kompani e licencuar për të ofruar shërbimet e Internetit, televizionit dixhital, IPTV/OTT, TV Broadcaster si dhe ndërtim të nyjve ndërkombëtare të internetit, me tregues shumë të mirë të performancës financiare. Vlera e aseteve të shoqërisë është rreth 2 herë më e lartë se e shoqërisë target.
- Shoqëria [...] është e specializuar në shërbimet që kanë lidhje procedurat e homologimit të automjetit, kontrollit teknik të automjeteve në qendrat e specializuara, e autorizuar nga [...]. Shoqëria paraqet tregues shumë të mirë të performancës financiare.
- Në vitet e ardhshme pala blerëse, nëpërmjet shoqërisë target synon: Zgjerimin e bazës së abonentëve përmes inovacionit në produkt dhe marketing; Rritje e penetrimit të platformës OTT dhe IPTV; Partneritete të reja me operatorë rajonalë për shpërndarje të përbashkët; Zhvillimi i përmbajtjes origjinale dhe kanaleve të dedikuara; Optimizim i rrjetit të shitjes dhe përmirësim i përvojës së klientit.

70. Nga sa më sipër konkludojmë se transaksioni i përfundimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK pritet të ndikojë në rritjen e performancës financiare të shoqërisë target dhe për pasojë në nxitjen e aftësisë konkurruese të shoqërisë Tring TV SHA në tregun përkatës.

71. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim në strukturat e tregut në Shqipëri dhe nuk pritet të shfaqë shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

**PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 57 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Tring TV SHA nga shoqëria Vertex Holding SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**  
**Nr. 1246 , Datë 12.12.2025**

**“PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT PARAPAK NDAJ NDËRMARRJES SHPRESA - AL SHPK NË TREGUN E TRANSPORTIT URBAN NË BASHKINË KAMËZ”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz.

**Baza Ligjore:** Neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

**VËREN SE :**

1. Nisur nga nga disa shqetësime të bëra publike në media dhe në bazë të disa ankesave të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me rritjen e çmimeve të biletave dhe aboneve të autobuzave të cilët operojnë në qytetin e Kamzës, Autoriteti i Konkurrencës në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, filloi monitorimin për analizimin e kushteve të tregut për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
2. Referuar shkresës së Bashkisë Kamëz nr. 962/2 prot., datë 27.11.2025 “Kthim përgjigje”, Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban ka depozituar pranë Këshillit Bashkiak Kamëz kërkesën duke argumentuar nevojën për rishikim dhe miratimin rritjes së çmimit të biletës së transportit urban me 10 (dhjetë) lekë, për linjën rrethqytetase mbi 8 km.

3. Kërkesa e Shoqatës së Transportit Urban dhe Interurban (protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr. 7767 prot., datë 10.06.2025), argumentonte se çmimi i biletës prej 40 (dyzetë) lekë ishte i pamjaftueshëm për të përballuar kostot reale të shërbimit të transportit dhe për të garantuar një shërbim cilësor për qytetarët. Kjo kërkesë ishte e mbështetur në faktorët si vijon: (i) rritja e çmimit të karburantit, e cila ka rritur ndjeshëm kostot e përditshme të operimit; (ii) kosto më të larta të mirëmbajtjes dhe pjesëve të këmbimit; (iii) rritja e pagave minimale që ka reflektuar në rritjen e shpenzimeve për pagat e stafit teknik dhe drejtuesëve të mjeteve; (iv) rritja e trafikut të renduar që rrit kostot e përditshme në konsumin e karburantit.
4. Këshilli Bashkiak me Vendimin nr. 66, datë 16.09.2025 “Mbi miratimin e çmimit të biletave dhe aboneve të linjave të transportit urban në Bashkinë Kamëz”, miratoi rritjen e çmimit të biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban mbi 8 km, për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Linjën Paskuqan – Babrru – Tiranë. Për këto linja rritja u reflektua si vijon: tarifa e biletës do të jetë 50 (pesëdhjetë) lekë; tarifa e abonesë mujore do të jetë 1400 (një mijë e katërqind) lekë; tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.
5. Referuar shkresës së Bashkisë Kamëz, për Linjën Kamëz – Tiranë – Kamëz, nëpërmjet Licencës nr. 31, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK. Si dhe për linjën Paskuqan 2 – Babrru – Tiranë – Babrru – Paskuqan 2, nëpërmjet Licencës nr. 33, lëshuar në datë 15.02.2017 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta rrethqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, është licencuar ndërmarrja SHPRESA - AL SHPK.
6. Në rastin konkret, SHPRESA - AL SHPK, zotëron pozitë dominuese në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003, pasi është i vetmi subjekt i cili është i licencuar nga Bashkia Kamëz për të ofruar transportin urban në linjat Kamëz – Tiranë – Kamëz dhe Paskuqan – Babrru – Tiranë, çka e bën detyrimin për të justifikuar rritjen e çmimeve.
7. Çdo rritje tarife duhet të mbështetet në analiza të qarta të kostos, të cilat tregojnë se kostot e shërbimit janë rritur dhe se çmimi aktual nuk i mbulon më këto kosto, duke e bërë rritjen ekonomikisht të nevojshme.
8. As Bashkia Kamëz, as Shoqata e Transportit Urban nuk kanë administruar apo paraqitur të dhëna ekonomike apo financiare që të provojnë se rritja e kërkuar dhe miratuar është: e mbështetur në analizë të plotë të kostove; e nevojshme për të mbuluar kostot e rritura; e arsyeshme dhe në përpjesëtim me shpenzimet reale të operatorit dhe e justifikuar mbi baza objektive të tregut.

9. Aktorët e biznesit kanë tendencë të keqpërdorin shoqatën e biznesit si një mjet për marrëveshje karteli ose praktika të tjera monopolistike, të kryera në mënyrë kolektive dhe sistematike përmes shoqatës së biznesit.<sup>6</sup> Kur një ndërmarrje ka pozitë dominuese, ekziston rreziku që çmimet të shtohen jo si pasojë e rritjes së kostove, por thjesht për shkak të mungesës alternative për konsumatorin.
10. Edhe pse shoqata nuk vendos çmimet vetë dhe nuk ka bashkëpunim midis konkurrentëve në këtë rast (sepse vetëm një operator operon në linjat përkatëse), roli i saj si përfaqësuese e operatorëve të transportit urban mund të justifikojë rritje çmimesh pa bazë objektive, duke lehtësuar mundësinë që ndërmarrja me pozitë dominuese të veprojë në dëm të konsumatorit.
11. Për sa më sipër, nisur nga problematika e ngritur, sjellja e ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK mund të përbejë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës bazuar në nenin 9, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 27.03.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

#### **VENDOSI:**

- I. Hapjen e procedurës së hetimit parapak ndaj ndërmarrjes SHPRESA - AL SHPK në tregun e transportit urban në Bashkinë Kamëz.
- II. Hetimi parapak të përfshijë periudhën kohore nga 1 janar 2025 deri në 12 dhjetor 2025.
- III. Raporti i hetimit parapak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**

---

<sup>6</sup> OECD “Trade Associations” 2007, fq. 237

**VENDIM**

**Nr.1247, Datë 19.12.2025**

**“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË FV PLANT 2 DRUŠTVO SA OGRANIČENOM ODGOVORNOŠĆU BEOGRAD - VRAČAR NGA SHOQËRIA GEN – I SONCE, ENERGETSKE STORITVE, D.O.O.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN – I SONCE, energetske storitve, d.o.o.

**Baza Ligjore:** Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve “Rasti i përfimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN - I SONCE, energetske storitve, d.o.o.”,

**VËREN SE :**

**I. Palët në transaksion dhe procedura**

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar për përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN - I SONCE, energetske storitve, d.o.o.

2. Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerjeje aksionesh” në lidhje me shitjen dhe blerjen e 100% të aksioneve në FV PLANT DOO BEOGRAD, nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: GEN - I SONCE, energetske storitve, d.o.o. (GEN – I SONCE d.o.o.)** është një shoqëri sllovene me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe futjen e njohurive të reja në fushën e efikasitetit të energjisë. GEN – I SONCE d.o.o. është pjesë e Grupit GEN - I, aktivitetet kryesore të të cilit janë tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike në tregjet me shumicë e pakicë.
4. Grupi GEN - I është i pranishëm në Shqipëri përmes shoqërisë GEN – I Tirana SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti tregti të energjisë elektrike sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për sektorin e energjisë elektrike, si dhe çdo aktivitet tjetër për shkak dhe të lidhur me objektin e mësipërm.
5. **Shitësi 1: LPK Energy Investments s.r.o.** është një shoqëri sllovake me përgjegjësi të kufizuar, e cila zotëron xx% të kapitalit të shoqërisë target (Aksioni i Shitjes 1 sipas marrëveshjes).
6. **Shitësi 2: PONCORN LIMITED** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Republikën e Qipros, e cila zotëron xx% të kapitalit të shoqërisë target (Aksioni i shitjes 2 sipas marrëveshjes).
7. **Shoqëria Target: FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar (FV PLANT 2 DOO BEOGRAD)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Serbisë. FV PLANT 2 DOO BEOGRAD është investitor (mbajtës i projektit) në ndërtimin e dy centraleve diellore në Serbi: [...]dhe [...] synon të ndërtojë, mirëmbajë dhe operojë centralet fotovoltaike të mësipërme.
8. FV PLANT 2 DOO BEOGRAD nuk ka degë dhe nuk ka gjeneruar xhiro në Shqipëri për vitin 2024.

## II. Përqendrimi

9. Ndërmjet shoqërisë GEN - I SONCE, energetske storitve, d.o.o. (në cilësinë e blerësit) dhe shoqërive LPK Energy Investments s.r.o. dhe PONCORN LIMITED (në cilësinë e shitësve) është lidhur “Marrëveshje shitblerjeje aksionesh” në lidhje me shitjen dhe blerjen e 100% të aksioneve në FV PLANT DOO BEOGRAD, nënshkruar më datë [...].
10. Në varësi të termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, shitësi 1 dhe shitësi 2 shesin dhe transferojnë Aksionet e shitjes 1 dhe 2, të cilat përbëjnë 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, tek blerësi, i cili blen dhe pranon këto aksione.
11. Transferimi i aksioneve të shitjes do të ndodhë pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në marrëveshje, të cilat duhet të përmbushen deri në datë [...], përndryshe blerësi do të ketë të drejtë ta ndërpresë marrëveshjen dhe transaksioni nuk do të vazhdojë.

12. Pas përfundimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target do të jetë në pronësi të plotë dhe do të kontrollohet nga GEN - I SONCE, energetske storitve, d.o.o.
13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN – I SONCE, energetske storitve, d.o.o., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni Konkurrencës.

### **III. Analiza e konkurrencës**

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet [...], por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 DOO BEOGRAD nga shoqëria GEN-I SONCE d.o.o.
16. GEN-I SONCE d.o.o. është një shoqëri aktive në tregtimin dhe shitjen e energjisë elektrike, pjesë e grupit të shoqërive GEN-I.
17. Grupi GEN-I ka një degë në Shqipëri, shoqërinë GENI-I Tirana SHPK, e cila operon si një tregtar dhe furnizues i licencuar i energjisë elektrike. Aktiviteti i saj përfshin tregtimin me shumicë të energjisë elektrike, transaksionet ndërkuftare dhe furnizimin e klientëve të kualifikuar.
18. FV PLANT 2 DOO BEOGRAD është një shoqëri aktive në prodhimin e energjisë elektrike. Targeti është një investitor i ndërtimit të dy centraleve të energjisë diellore në Serbi, [...]. Shoqëria synon të ndërtojë, mirëmbajë dhe operojë këto termocentrale fotovoltaike.
19. Aktualisht, FV PLANT 2 nuk ka ende aktivitete në treg për prodhimin dhe shitjen me shumicë të energjisë elektrike në Serbi dhe nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri.
20. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime në tregun shqiptar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

**VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë FV PLANT 2 društvo sa ograničenom odgovornošću Beograd - Vračar nga shoqëria GEN – I SONCE, energetske storitve, d.o.o.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 1248, Datë 19.12.2025**

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË  
SPECIALIZIMIT.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit.”

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës,** pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit.”

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të specializimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rregullorja Nr. 190, datë 26.05.2011 “Per perjashtimin e kategorive te marreveshjeve te specializimit” shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

RREGULLORE  
“PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË  
SPECIALIZIMIT”

Neni 1

Objekti

1. Kjo Rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve që duhet të përmbushin marrëveshjet e specializimit (siç përkufizohen më poshtë) për të përfituar nga përjashtimi nga ndalimi i nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (referuar në vijim si “Ligji”), në përputhje me nenin 5 dhe 6 të këtij ligji.
2. Përfitimi i përjashtimit në bllok i vendosur nga kjo Rregullore duhet të kufizohet në rastet kur palët janë aktive në të njëjtin treg produkti. Megjithatë, nuk është e nevojshme që palët të jenë në të njëjtin treg gjeografik.
3. Përjashtimi i vendosur nga kjo Rregullore nuk duhet të zbatohet për marrëveshjet që përmbajnë kufizime të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e efekteve pozitive të krijuara nga një marrëveshje specializimi.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
  - a) “*marrëveshje specializimi*” do të thotë një marrëveshje specializimi e njëanshme, një marrëveshje specializimi reciproke ose një marrëveshje prodhimi e përbashkët:
    - (i) “*marrëveshje specializimi e njëanshme*” do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve që janë aktive në të njëjtin treg produkti dhe sipas së cilës një ose më shumë palë bien dakord të ndërpresin plotësisht ose pjesërisht prodhimin e produkteve të caktuara ose të heqin dorë nga prodhimi i këtyre produkteve dhe t’i blejnë ato nga një ose disa palë të tjera, të cilat bien dakord t’i prodhojnë dhe t’i furnizojnë ato;

- (ii) *“marrëveshje specializimi reciproke”* do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve që janë aktive në të njëjtin treg produkti dhe sipas së cilës dy ose më shumë palë, në baza reciproke, bien dakord të ndërpresin ose të heqin dorë plotësisht ose pjesërisht nga prodhimi i produkteve të caktuara por të ndryshme ose të heqin dorë nga prodhimi i këtyre produkteve dhe t’i blejnë ato nga një ose më shumë palë të tjera, të cilat bien dakord t’i prodhojnë dhe t’i furnizojnë ato;
- (iii) *“marrëveshje prodhimi e përbashkët”* do të thotë një marrëveshje sipas së cilës dy ose më shumë palë bien dakord të prodhojnë produkte të caktuara së bashku;
- b) *“marrëveshje”* ka kuptimin që i është dhënë në nenin 3, paragrafi 4 të Ligjit;
- c) *“produkt”* do të thotë një mall ose një shërbim, duke përfshirë mallrat ose shërbimet ndërmjetëse dhe mallrat ose shërbimet përfundimtare, me përjashtim të shërbimeve të shpërndarjes dhe dhënies me qira;
- d) *“prodhim”* do të thotë prodhimi i mallrave ose përgatitja e shërbimeve, duke përfshirë edhe me anë të nënkontraktimit;
- e) *“përgatitja e shërbimeve”* do të thotë veprimtaritë e kryera në rrjedhën e sipërme të ofrimit të shërbimeve për klientët;
- f) *“produkt specializimi”* do të thotë një produkt që prodhohet në bazë të një marrëveshje specializimi;
- g) *“produkt i rrjedhës së poshtme”* do të thotë një produkt për të cilin një produkt specializimi përdoret si input nga një ose më shumë palë dhe i cili shitet nga ato palë në treg;
- h) *“treg përkatës”* do të thotë tregu përkatës i produktit dhe gjeografik të cilit i përkasin produktet e specializimit, dhe, gjithashtu, kur produktet e specializimit janë produkte ndërmjetëse që përdoren plotësisht ose pjesërisht nga një ose më shumë palë, për përdorim të brendshëm (captive) si inpute për prodhimin e produkteve të rrjedhës së poshtme, tregu përkatës i produktit dhe gjeografik të cilit i përkasin produktet e rrjedhës së poshtme;
- i) *“ndërmarrje konkurruese”* do të thotë një konkurrent aktual ose potencial;
- (i) *“konkurrent aktual”* do të thotë një ndërmarrje që është aktive në të njëjtin treg përkatës;
- (ii) *“konkurrent potencial”* do të thotë një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes së specializimit, do të kishte gjasa, në baza reale dhe jo thjesht si një mundësi teorike, brenda jo më shumë se 3 viteve, të kryente investimet e nevojshme shtesë ose të përballonte kostot e nevojshme për të hyrë në tregun përkatës;

<sup>1</sup> (32023R1067) Rregullorja e Komisionit BE 2023/1067 e 1 qershorit 2023 mbi zbatimimin e Nenit 101(3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në kategori të caktuara të marrëveshjeve të specializimit

- j) “*detyrim ekskluziv i furnizimit*” do të thotë një detyrim për të mos furnizuar me produktet e specializimit një ndërmarrje konkurruese të ndryshme nga një ose disa palë në marrëveshjen e specializimit;
  - k) “*detyrim ekskluziv i blerjes*” do të thotë një detyrim për të blerë produktet e specializimit vetëm nga një ose disa palë në marrëveshjen e specializimit;
  - l) “*i përbashkët*”, në kontekstin e shpërndarjes, do të thotë veprimtaritë ku puna e përfshirë:
    - (i) kryhet nga një ekip i përbashkët, organizatë ose ndërmarrje; ose
    - (ii) ndërmerret nga palë e tretë shpërndarëse i emëruar së bashku mbi baza ekskluzive ose joekskluzive, me kusht që pala e tretë të mos jetë një ndërmarrje konkurruese;
  - m) “*shpërndarje*” do të thotë shitja dhe furnizimi i produkteve të specializimit tek klientët, duke përfshirë tregtimin e këtyre produkteve;
  - n) “*Komisioni i Konkurrencës*” do të thotë struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës.
2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat “*ndërmarrje*” dhe “*palë*” do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura. “*Ndërmarrje të lidhura*” do të thotë:
- a) ndërmarrjet tek të cilat një palë në marrëveshjen e specializimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka një ose më shumë prej të drejtave apo kompetencave vijuese:
    - (i) kompetencën për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës;
    - (ii) kompetencën për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, këshillit të administrimit ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen;
    - (iii) të drejtën e administrimit të veprimtarisë së ndërmarrjes;
  - b) ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshjen e specializimit, një ose më shumë prej të drejtave ose kompetencave të renditura në germën a);

- c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në germën b) ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një ose më shumë prej të drejtave ose kompetencave të renditura në germën a);
- d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e specializimit së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në gerrat a), b) ose c), ose në të cilat dy ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në gerrat a), b) ose c), kanë së bashku një ose më shumë prej të drejtave ose kompetencave të renditura në germën a);
- e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a) mbahen bashkërisht nga:
  - (i) palët në marrëveshjen e specializimit ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura të përmendura në gerrat a) deri d), *ose*
  - (ii) një ose më shumë nga palët në marrëveshjen e specializimit ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në gerrat a) deri d) dhe një ose më shumë palë të treta.

### Neni 3 Përjashtimi

1. Në bazë të nenit 5 dhe 6 të Ligjit dhe në varësi të dispozitave të kësaj Rregulloreje, neni 4 i Ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit.
2. Përjashtimi i përcaktuar në paragrafin 1 zbatohet deri në masën që këto marrëveshje përmbajnë kufizime të konkurrencës që bien në objektin e nenit 4 të Ligjit.
3. Përjashtimi i përcaktuar në paragrafin 1 zbatohet edhe për marrëveshjet e specializimit që përmbajnë dispozita që lidhen me transferimin ose licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale tek një ose më shumë nga palët, me kusht që këto dispozita të lidhen drejtpërdrejt dhe të jenë të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes dhe të mos përbëjnë objektin kryesor të marrëveshjes.
4. Përjashtimi i përcaktuar në paragrafin 1 zbatohet gjithashtu për marrëveshjet e specializimit ku:
  - a) palët pranojnë një detyrim ekskluziv të blerjes ose të furnizimit; ose
  - b) palët shpërndajnë bashkërisht produktet e specializimit.

#### Neni 4

##### Pragu i pjesës së tregut

1. Përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 do të zbatohet me kusht që pjesa e kombinuar e tregut të palëve të mos kalojë 20% në tregun/tregjet përkatës/e të cilit/ave iu përkasin produktet e specializimit.
2. Kur produktet e specializimit janë produkte ndërmjetëse që përdoren plotësisht ose pjesërisht nga një ose më shumë palë për përdorim të brendshëm (captive) si inpute për prodhimin e produkteve të rrjedhës së poshtme, të cilat ato gjithashtu i shesin, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 do të zbatohet vetëm nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:
  - a) pjesa e kombinuar e tregut të palëve nuk kalon 20% në tregun/tregjet përkatës/e të cilit/ave iu përkasin produktet e specializimit;
  - c) pjesa e kombinuar e tregut të palëve nuk kalon 20% në tregun/tregjet përkatës/e të cilit/ave iu përkasin produktet e rrjedhës së poshtme.

#### Neni 5

##### Zbatimi i pragut të pjesës së tregut

1. Për qëllimet e zbatimit të pragut të pjesës së tregut të parashikuar në nenin 4, zbatohen rregullat e mëposhtme:
  - a) pjesët e tregut do të llogariten në bazë të vlerës së shitjeve të pjesëve në treg; nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg nuk janë të disponueshme, mund të përdoren vlerësime të bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë vëllimet e shitjeve në treg;
  - b) pjesët e tregut do të llogariten në bazë të të dhënave të vitit kalendarik paraardhës ose, kur viti kalendarik paraardhës nuk është përfaqësues i pozicionit të palëve në tregun/tregjet përkatës/e, pjesët e tregut do të llogariten si një mesatare e pjesëve të tregut të palëve për 3 vitet kalendarike paraardhëse;
  - c) pjesa e tregut e zotëruar nga ndërmarrjet e përmendura në nenin 2, paragrafi 2, germa (e) do t'i ndahet në mënyrë të barabartë secilës ndërmarrje që ka një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e renditura në nenin 2, paragrafi 2, germa a);

- d) nëse pjesët e tregut të përmendura në nenin 4 fillimisht nuk janë më shumë se 20%, por më pas rriten mbi atë nivel në të paktën një prej tregjeve përkatëse, përjashtimi i vendosur në nenin 3 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 2 vitesh kalendarike të njëpasnjëshme pas vitit në të cilin është tejkaluar për herë të parë pragu prej 20%.

#### Neni 6

##### Kufizimet e rënda

Përjashtimi i vendosur në nenin 3 nuk do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt një nga të mëposhtmit:

- a) fiksimin e çmimeve në shitjen e produkteve të specializimit tek palët e treta, me përjashtim të fiksimit të çmimeve për t'u paguar nga klientët e drejtëpërdrejtë në kontekstin e shpërndarjes së përbashkët;
- b) kufizimin e prodhimit ose shitjeve, me përjashtim të:
- (i) dispozitave për sasinë e produkteve të rëna dakord në kontekstin e marrëveshjeve të specializimit të njëanshme ose reciproke;
  - (ii) të vëllimeve të kapacitetit dhe prodhimit në kontekstin e një marrëveshjeje të përbashkët prodhimi;
  - (iii) përcaktimit të objektivave të shitjeve në kontekstin e shpërndarjes së përbashkët.
- c) ndarjen e tregjeve apo klientëve.

#### Neni 7

##### Revokimi në raste individuale

1. Në përputhje me nenet 48 deri 51 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përfitimin nga përjashtimi sipas kësaj Rregulloreje, nëse konstaton në ndonjë rast të veçantë se një marrëveshje specializimi së cilës i zbatohet përjashtimi i vendosur nga kjo Rregullore ka gjithësesi efekte që janë të papajtueshme me nenin 5 dhe 6 të Ligjit.
2. Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përfitimin nga përjashtimi sipas kësaj Rregulloreje, në përputhje me nenet 48 deri 51 të Ligjit, në veçanti kur tregu përkatës ka përqëndrim të lartë dhe konkurrenca tashmë është e dobët, për shembull për shkak të një ose më shumë nga sa vijon:

- a) pozicionet individuale në treg të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
- b) lidhjet ndërmjet pjesëmarrësve të tjerë të tregut të krijuara nga marrëveshjet paralele të specializimit;
- c) lidhjet ndërmjet palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.

#### Neni 8

##### Periudha kalimtare

Ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nuk do të zbatohet gjatë periudhës prej dy vitesh duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje në lidhje me marrëveshjet që janë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të cilat nuk plotësojnë kushtet për përjashtim të parashikuara në këtë Rregullore, por të cilat plotësojnë kushtet për përjashtim të parashikuara në Rregulloren “Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit”, të miratuar me vendimin Nr. 190, datë 26 maj 2011, të Komisionit të Konkurrencës.

#### Neni 9

##### Shfuqizime

Rregullorja “Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit”, e miratuar me vendimin Nr. 190, datë 26 maj 2011, të Komisionit të Konkurrencës, shfuqizohet.

#### Neni 10

##### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.

**VENDIM**

**Nr. 1249, Datë 19.12.2025**

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR PËRJASHTIMIN NË BLOK TË KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE  
VERTIKALE DHE PRAKTIKAVE TË BASHKËRENDUARA”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Rregullorja Nr. 234, datë 19.07.2012 “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”, shfuqizohet.
  3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<https://caa.gov.al/wp-content/uploads/2026/01/VENDIMI-NR-1249-MBI-MIRATIMIN-E-RREGULLORES-MARREVESHJE-VERTIKALE-PRAKTIKAVE-TE-BASHKERENDUARA.pdf>

**VENDIM**

**Nr. 1250, Datë 19.12.2025**

**MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT  
“MBI KUFIZIMET VERTIKALE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Mbi miratimin e Udhëzimit “Mbi kufizimet vertikale”

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - udhëzimit “Mbi kufizimet vertikale”

**VENDOSI:**

1. Miratimin e udhëzimit “Mbi kufizimet vertikale” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Udhëzimi Nr. 352, datë 03.03.2015 "Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale." shfuqizohet.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I KONKURRENCËS**

<https://caa.gov.al/decisions/vendim-nr-1250-date-19-12-2025/>

**VENDIMET E  
KOMISIONIT TË  
KONKURRENCËS  
2025**  
BULETINI ZYRTAR



2025